



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT
(Përfundimtar)

INSPEKTIM I PËRGJITHSHËM
NË LIDHJE ME ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN
E SHËRBIMIT CIVIL

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Tiranë, Qershor 2015

RAPORT

Për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil Këshilli i Qarkut Korçë.

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është vënë në dijeni të faktit se Këshilli i Qarkut Korçë, është përfshirë në proces ristrukturimi, nëpërmjet një informacioni të marrë nga disa punonjës të këtij institucioni, ndaj të cilëve është vendosur fillimisht pezullimi e më pas, lirimi nga shërbimi civil, duke përdorur si argument shkurtimin e pozicionit të punës.

Duke e konsideruar aktin administrativ të lirimit të tyre nga shërbimi civil, si të kryer në kundërshtim me procedurën e parashikuar në nenin 50 e vijues të ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), si dhe duke pasur parasysh kompetencat e Komisionerit, si institucioni që mbikëqyr administrimin e shërbimit civil, këta punonjës, e kanë informuar Komisionerin në lidhje me pretendimet e tyre për parregullsitë e lejuara nga ana e institucionit gjatë administrimit të këtij procesi.

Në këto rrethana, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, duke vlerësuar se ky informacion duhet të verifikohet, me aktin administrativ nr. 21, datë 11.03.2015, "Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshillit të Qarkut Korçë", ka vendosur kryerjen e inspektimit të përgjithshëm, duke përfshirë procesin e ristrukturimit dhe duke e zgjeruar objektin në të gjitha institutet e tjera të ligjit për nëpunësin civil.

Sipas vendimit të Komisionerit, inspektimi u planifikua të fillonte në institucion, në datën 17.03.2015 dhe të përfundonte, brenda datës 10.04.2015, sipas programit të inspektimit dhe njoftimit të dërguar në subjekt, me shkresën nr. 244/1 prot., datë 11.03.2015 "Njoftim për fillimin e inspektimit në institucionin, Këshilli i Qarkut Korçë".

Ndërkohë, me shkresën nr. 482 prot. datë 25.03.2015, nga ana e titullarit të institucionit të inspektuar, i është kërkuar Komisionerit, shtyrja e afatit të fillimit të inspektimit, me pretendimin se, në datën 25. 03.2015 është miratuar struktura e re e Këshillit të Qarkut dhe se vendimi për hyrjen në fuqi të saj, kërkon një kohë të caktuar që ka lidhje me konfirmimin e bazueshmërisë ligjore nga ana e Prefektit të Qarkut Korçë, në zbatim të nenit 54, gërma "d", të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

Në këto kushte, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke e vlerësuar kërkesën e institucionit si të bazuar, me Vendimin nr. 32, datë 03.04.2015, ka miratuar shtyrjen e afatit të inspektimit në Këshillin e Qarkut Korçë, në një afat të arsyeshëm, deri në datën 10.04.2015.

Me përfundimin e këtij afati, grupi i inspektimit, i përbërë nga inspektorët Alda Xhaxhiu dhe Ledina Zhupa, vijoi procesin nëpërmjet komunikimit me institucionin nëpërmjet të gjitha rrugëve

ligjore, si me postë, komunikim elektronik dhe vizitave në subjekt dhe pasi u grumbulloi të dhënat dhe materialet e nevojshme, inspektimi kaloi në fazën e përpunimit të tyre dhe hartimit të projektraportit, i cili me shkresën nr.244/8, datë 01.06.2015 “*Dërgohet projekt raporti*”, u dërgua për njohje në subjektin e inspektimit dhe u la 10 ditë kohë, me qëllim që të mundësohet e drejta e vërejtjeve, në lidhje me parregullsitë e konstatuara në këtë material.

Pas përfundimit të kësaj faze, me shkresën e regjistruar pranë Komisionerit, me nr. 244/9, datë 08.06.2015 “*Kthim përgjigje*”, projekt raporti u kthye nga institucioni i inspektuar pa vërejte, si dhe i nënshkruar nga titullari i institucionit dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore dhe pas kësaj u përgatit raporti përfundimtar i inspektimit.

Qëllimi i inspektimit:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë edhe detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar).

Objekti i inspektimit:

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar), në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përkrahimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, dt.11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit Civil*”, apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit;
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
 - Rastet e refuzimit të deklaramit të statusit të nëpunësit civil;

- Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve.
 - Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithëshme të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar).
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.
 4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
 5. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar).
 6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*detyrimet e nëpunësit dhe institucionit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
 7. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*).
 8. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.
 9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (*kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të Përhershëm të Disiplinës, etj.*).
 10. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues*).
 11. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.

12. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Metodologjia e inspektimit:

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të inspektimit të përcaktuar në Vendimin nr. 21, datë 11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, grupi i inspektimit verifikoi dhe shqyrtoi dokumentacionin nëpërmjet këqyrjes së materialeve të administruara në dosjet e personelit dhe në arkivën e institucionit.

- U verifikuan të gjitha pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës së institucionit;
- U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe përmbajtja e dosjeve individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër, të kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil;
- U verifikua nëse përshkrimet edhe vlerësimet individuale të punës për pozicionet pjesë të shërbimit civil, janë të hartuara në përputhje me formatin standard të miratuar;
- Të dhënat profesionale si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës si arsimi, përvoja në punë e të tjera;
- Aktet që materializojnë ndryshimet strukturore:
 - Vendimi nr. 21 datë 28.12.2012 "Për miratimin e strukturës dhe klasifikimin e nivelit të pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë";
 - Vendimi nr.32 datë 25.03.2015 "Për miratimin e strukturës organizative dhe klasifikimin e nivelit të ri të pagave të punonësve të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë dhe Ndërmarrjeve të varësisë";
 - Vendimi nr.15 datë 30.08.2014 "Për miratimin e strukturës organizative dhe klasifikimin e nivelit të ri të pagave të punonësve të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë";
 - Vendimi nr.1, datë 29.01.2015 "Për delegimin e kompetencave në lidhje me strukturën e këshillit të qarkut dhe ndërmarrjeve në varësi dhe zbatimin e detyrimeve të lindura nga ligji nr. 160/2014 "Për buxhetin e vitit 2015" dhe Udhëzimi nr.2, datë 09.01.2015, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015";
 - Urdhëri nr. 22, datë 12.02.2015, "Për emërimin e nëpunësve dhe punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë sipas strukturës së re";
 - Shkresa nr. 436/1, datë 14.04.2015, e Prefektit të Qarkut Korçë "Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit";
 - Rregullore e Funkcionimit të Brendshëm të Administratës së Këshillit të Qarkut të Korçës;
 - Akt konstatimi i mbajtur nga Komisioni i Ristrukturimit nr. 223 datë 06.02.2015;
 - Vendimi nr. 223/1, datë 06.02.2015 i njësisë përgjegjëse për pezullimin e punonjësve;

- o Urdhëri nr. 36, datë 18.05.2015 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre administrative për disa nëpunës të Këshillit të Qarkut, për arsye të ristrukturimit të administratës.”
- o Listëpagesat e muajit shkurt 2014, për të gjithë punonjësit e institucionit;
- o Listëpagesat e muajit janar 2015 për të gjithë punonjësit e institucionit.

Konstatimet e inspektimit janë të materializuara si anekse më vete në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij raporti si më poshtë:

- **Aneksi 1:** “Aktet që materializojnë emërimet në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), nëpërmjet emërimit të përkohshëm, pa procedura konkurimi. (pas datës 26.02.2014).”
- **Aneksi 2:** “Respektimi i kërkesave të përgjithëshme, sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion”.
- **Aneksi 3:** “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit aktualë, të cilët kanë punuar në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të punësuar nëpërmjet konkurimit (data 26.02.2014)”.
- **Aneksi 4:** “Ecuria e marrëdhënies së punësimit për punonjësit e Këshillit të Qarkut Korçë”.

Përmbajtja e raportit:

- I. **Deklarimi i statusit të punësimit dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.**
 - I. Strukturimi i institucionit dhe ndarja e pozicioneve të punës në momentin e inspektimit.

Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), ka vendosur rregulla të qarta për mënyrën e administrimit të shërbimit civil, për të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të tij.

Në nenin 2 të këtij ligji, përcaktohet se subjekt i tij është çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore, por njëkohësisht evidentohen dhe rastet përjashtimore për disa funksione të identifikuar shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit.

Këshilli i Qarkut Korçë, është krijuar dhe funksionon si organ përfaqësues i Qarkut, mbi bazën e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.03.2004, i cili në nenet 5 dhe 6 të tij, e përcakton atë si njësi të qeverisjes vendore, e për këtë arsye, ky institucion përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil.

Administrata e Këshillit të Qarkut funksionon mbi bazën e strukturës organizative të miratuar nga Këshilli i Qarkut, sipas parashikimeve të nenit 54 të ligjit 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ku përcaktohen detyrat dhe kompetencat e Këshillit të Qarkut.

Aktualisht, subjekti i inspektimit, funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr.32, datë 25.03.2015 “Për miratimin e strukturës organizative dhe klasifikimin e nivelit të ri të pagave të punonësve të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë dhe Ndërrmarrjeve të varësisë”, ndërsa në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), (datë 26.02.2014), Këshilli i Qarkut Korçë ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr. 21, datë 28.12.2012 të Këshillit të Qarkut, “Për miratimin e strukturës dhe klasifikimin e nivelit të pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë”.

Duke patur parasysh klasifikimin e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar), si dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, sipas strukturës aktuale, rezulton se administrata e Këshillit të Qarkut Korçë ka gjithsej 22 pozicione pune, nga të cilat 7 pozicione pune janë të nivelit administrativ (mbështetëse) dhe marrëdhëniet e punës në këtë rast rregullohen sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë dhe 15 pozicione pune, janë pjesë e shërbimit civil dhe ndahen në këto kategori:

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues, rezulton të jetë 1 pozicion pune, që i përket pozicionit “Përgjegjës sektori”;
- Nëpunës civilë të nivelit ekzekutiv janë 14 pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “specialist/inspektor”.

Konkluzion: Nisur nga funksionet e çdo pozicioni pune që është përfshirë në shërbimin civil, duke u bazuar në Rregulloren e Brendshme të institucionit, Komisioneri konstaton se në lidhje me metodologjinë e ndjekur për klasifikimin e pozicioneve të punës në këtë institucion, në strukturën e institucionit, është realizuar një ndarje e drejtë midis pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, nga ato që kryejnë funksione administrative.

Por, në këtë moment, Komisioneri duhet të sjellë në vëmendjen e njësisë përgjegjëse se, gjatë hartimit të strukturës së institucionit, duhet të mbahen parasysh disa kërkesa specifike të ligjeve të veçanta që ndërveprojnë gjatë funksionimit të institucionit.

Bëhet fjalë për ligjin që ka të bëjë me funksionimin e sektorit të financës, me qëllim që të sigurohet raporti nëpunës autorizues dhe nëpunës zbatues (ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”), apo për ligjet që rregullojnë funksionet e deleguara në pushtetin vendor nga administrata shtetërore, të cilat në dispozita të veçanta të tyre, përcaktojnë edhe mënyrën e organizimit të njësisë të tilla, si Seksionet e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Inspektoriatet etj.

2. Si është kuptuar dhe zbatuar neni 67 i ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Nisur nga fakti që Këshilli i Qarkut Korçë është pjesë e shërbimit civil, deklarimi i statusit të punësimit për çdo nëpunës që gjeti në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, fillimi i efekteve juridike të ligjit, duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur se:

- pika 3, "Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi nëpunësit civil", apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë";
- pika 4 "Nëpunës ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji";
- pika 6 Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit".

Po kështu, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave,"Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Kreu II "Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet", pika 1, është përcaktuar se: "Nëpunës civilë", sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Këto janë dispozitat bazë që duhet të mbajë parasysh njësia përgjegjëse për të realizuar drejt detyrimin ligjor të deklarimit të statusit të punësimit.

Për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, grupi i inspektimit verifikoi dhe analizoi materialet shkresore të ardhura nga institucioni, këqyri në subjekt dokumentacionin e administruar në dosjen personale të nëpunësve dhe analizoi aktet administrative që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si organigramën dhe strukturën analitike të institucionit, të miratuar me Vendimin nr. 21, datë 28.12.2012 "Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë", e cila ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.

Në parantezë të analizës së këtij aspekti të rëndësishëm të administrimit të shërbimit civil, duhet të vemë në dukje faktin se të dhënat në këtë rast janë nxjerrë nga përmbajtja e akteve të emërimit të administruara në dosjen e personelit, pasi grupi i mbikëqyrjes nuk ka mundur të verifikojë ne

detaje procesin e rekrutimit, që ka të bëjë me të gjitha fazat e tij, në përputhje me ligjin e mëparshëm nr.8549, datë 1999 "Statusi i nëpunësit civil", tashmë i shfuqizuar.

Kjo për faktin se nga ana e institucionit është pretenduar se punonjësit që kanë administruar më parë dokumentacionin e burimeve njerëzore të institucionit dhe tani nuk janë më pjesë e tij, nuk i kanë dorëzuar materialet të plota, tek punonjësit që e kryejnë aktualisht këtë funksion.

Për këtë arsye, të dhënat e paraqitura në këtë rubrikë, kanë dalë nga analiza e përmbajtjes së akteve të emërimit, të cilat na janë vënë në dispozicion gjatë inspektimit, nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në këto kushte, për disa arsye, së pari, me qëllim që të mundësohet procesi i verifikimit të procedurave të rekrutimit nga grupi i inspektimit dhe së dyti për të plotësuar dosjen e personelit në mbështetje të procesit të deklarimit të statusit të punësimit, që kërkon verifikimin e procedurës së emërimit, njësia përgjegjëse duhet të bashkëpunojë me punonjësin që e ka kryer më parë këtë detyrë, me arkivën e institucionit, si dhe me vetë nëpunësit civilë, me qëllim që të plotësohet praktika dhe të jetë e disponueshme për të gjitha arsyet që përmendëm më sipër.

Në përfundim të kësaj analize, statusin e punësimit të punonjësve të këtij institucioni sipas strukturës që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar), mund t'a paraqesim në këtë mënyrë:

a. Nëpunës të cilëve i është deklaruar statusi i punësimit në kategorinë e nëpunësve civilë.

Nisur nga verifikimi i akteve të deklarimit të statusit të punësimit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar), punonjësit që kanë fituar statusin e nëpunësit civil sipas kërkesave të pikës 3 të nenit 67 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar), si dhe pikës 1 të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", Kreu II "Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet", janë si më poshtë:

1. ***** , në pozicionin e punës "Drejtor në Drejtorinë e Investim Shërbimeve";
2. ***** , në pozicionin e punës "Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë e Investim Shërbimeve"
3. ***** , në pozicionin e punës "Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë e Investim Shërbimeve";
4. ***** , në pozicionin e punës "Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë e Investim Shërbimeve";
5. ***** , në pozicionin e punës "Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë e Investim Shërbimeve"
6. ***** , në pozicionin e punës "Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë e Urbanistikës;
7. ***** , në pozicionin e punës "Drejtor në Drejtorinë e Projekteve Komunitare dhe Urbanistikës"

8. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë e Projekteve Komunitare*”;
9. ***** , në pozicionin e punës “*Drejtor në Drejtorinë Financës*”;
10. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë e Financës*”;
11. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Financës*”;
12. ***** , në pozicionin e punës “*Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe Personelit*”;
13. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë Juridike dhe personelit*”;
14. ***** , në pozicionin e punës “*Kryeinspektor i Nivelit të Lartë në Inspektoriatin e Mbrojtjes Tokës*”;
15. ***** , në pozicionin e punës “*Inspektor i Nivelit të Lartë në IMT*”;
16. ***** , në pozicionin e punës “*Inspektor i Nivelit të Lartë në IMT*”;
17. ***** , në pozicionin e punës “*Inspektor i Nivelit të Lartë në IMT*”;

Kjo kategori e punonjësve është konfirmuar nga njësia përgjegjëse me statusin e nëpunësit civil dhe do të trajtohet në mënyrë të detajuar në vijim të materialit, ku do të analizohen edhe aktet administrative që mbështesin procesin e deklarimit të statusit të punësimit.

b. Nëpunës të cilëve nuk i është deklaruar statusi i punësimit.

Konstatohet se në disa raste, pavarësisht faktit se momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit i ka gjetur punonjësit në punë, në pozicione që janë pjesë e shërbimit civil dhe që njëkohësisht i plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil, njësia përgjegjëse nuk është shprehur për statusin e punësimit dhe konkretisht bëhet fjalë për punonjësit:

1. ***** , në pozicionin e punës “*Drejtor urbanistike*”
2. ***** , në pozicionin e punës “*Përgjegjës në Drejtorinë e Urbanistikës*”
3. ***** , në pozicionin e punës “*Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë e Projekteve Komunitare*”
4. ***** , në pozicionin e punës “*Kryeinspektor i Inspektoriatit të Ndërtimit*”
5. ***** , në pozicionin e punës *Inspektor i nivelit të lartë në INU*
6. ***** , në pozicionin e punës *Specialist në Drejtorinë Juridike dhe Personelit.*

Këto pozicione do të analizohen në mënyrë të detajuar në pjesën vijuese të raportit të inspektimit, duke analizuar dhe aktet administrative që rregullojnë marrëdhënien e tyre të punës.

Konkluzion. Për të gjitha sa analizuam me sipër (nëndarja “a”), Komisioneri vlerëson se njësia përgjegjëse ka vepruar drejt në rastin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil.

Nga ana tjetër, në rastin kur njësi përgjegjëse nuk është shprehur për statusin e punësit (nëndarja "b"), rekomandohet njësi përgjegjëse që të vijojë punën me procesin e verifikimit të statusit të punësit dhe më tej, të konfirmojë pozicionin e tyre në raport me sistemin e shërbimit civil, ashtu si është rekomanduar në vijim të raportit të inspektimit.

Ky veprim bën të mundur qartësimin e situatës së tyre në lidhje me proceset e administrimit të shërbimit civil, si procesi i rekrutimit, i ristrukturimit, vlerësimit të punës, sistemit të karrierës, etj.

II. Transferimi në shërbimin civil në rastin e ristrukturimit të institucionit.

Fakti që subjekti i inspektimit ka kaluar disa herë në proces ristrukturimi, si para ashtu edhe pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), passjell edhe vështirësi në administrimin e tij gjatë implementimit në praktikë.

Në një rast të ristrukturimit të institucionit, njësi e burimeve njerëzore, që është mekanizmi i ngarkuar me përgatitjen e kushteve, që ky proces të zhvillohet në rrugën e duhur, duhet që të mbajnë parasysh rendin e punës gjatë këtij procesi, që përfaqëson një procedurë të caktuar, që fillon me **a**) një studim të veçantë (relacion), që përlligj nevojën e institucionit për t'u përfshirë në ristrukturim dhe duhet të vazhdojë **b**) me hartimin e përshkrimit të punës e përcaktimin e kërkesave të përgjithshme e të veçanta për vendet e reja të punës që do të krijohen rishtas, apo ato të ristrukturuara, me qëllim që të bëhet i mundur sistemimi i punonjësve aktualë, si dhe **c**) me parashikimin e pasojave financiare që sjell ky proces.

Po kështu, duhet të mbahet parasysh edhe detyrimi ligjor që ka institucioni që në rast ristrukturimi, nëpunësit të sistemohen brënda numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë, duke e konsideruar kalimin në listën e pritjes si mjetin e fundit që duhet të përdoret për largimin e nëpunësve civilë, me qëllim që të sigurohet **1**) memorja institucionale **2**) investimet e bëra nga institucioni tek nëpunësit civilë dhe **3**) të evitohet dëmi financiar në buxhetin e shtetit.

Më poshtë po analizojmë me radhë strukturat me të cilat ka funksionuar institucioni për periudhën 2012-2015, të cilat janë edhe aktet që në fakt e materializojnë procesin e ristrukturimit dhe nëpërmjet krahasimit të tyre, do të nxjerrim në pah ndryshimet që kanë ndodhur si dhe problematikën e hasur në këtë rast.

- o Struktura e miratuar me Vendimin nr. 21, datë 28.12.2012 "Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë".

Në këtë rast, në përbërje të administratës së Këshillit të Qarkut, kanë qenë gjithsej **38** pozicione pune, nga të cilët, **24** pozicione pjesë e shërbimit civil dhe **14** pozicione, funksione mbështetëse, në mënyrë të detajuar si më poshtë:

1. *Drejtoria e Investimeve dhe Shërbimeve*
 - Drejtor* 1
 - Specialist të nivelit të lartë* 4

2. Drejtoria e Urbanistikës	
Drejtor	1
Përgjegjës	1
Specialist i nivelit të lartë	1
3. Drejtoria e projekteve komunitare	
Drejtor	1
Specialist i nivelit të lartë	2
4. Drejtoria e Financës	
Drejtor	1
Specialist i nivelit të lartë	2
5. Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik	
Kryeinspektori IN	1
Inspektor i nivelit të lartë	2
Inspektor i nivelit të mesëm	1
6. Drejtoria Juridike dhe e Personelit	
Drejtor	1
Specialist i nivelit të lartë	1
Specialist i nivelit të mesëm	1
7. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës	
(Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës)	-
Kryeinspektor	1
Inspektor i nivelit të lartë	2

Totali **24 nëpunës civil**

- Struktura e miratuar me Vendimin nr.15, datë 30.08.2014, të Këshillit të Qarkut Korçë, "Mbi miratimin e strukturës organizative dhe klasifikimin e nivelit të ri të pagave për administratën".

Sipas kësaj strukture, numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës ishte **56**, nga të cilët **41** pozicione pune, pjesë e shërbimit civil dhe **13** pozicione pune në funksione mbështetëse

Struktura e aparatit të institucionit në këtë rast ka qenë e organizuar në këtë mënyrë:

1. Zyra e Informacionit e kryetarit	
Specialist i nivelit të mesëm	2
2. Drejtoria e Koordinimit të politikave të Qarkut,	7
Drejtor,	1

<i>Sektori i koordinimit, hartimit, zbatimit të projekteve,</i>	
<i>përgjegjës sektori</i>	1
<i>Specialist i nivelit të lartë</i>	2
<i>Sektori për mbrojtjen dhe zhvillimit mjedisor, me organikë</i>	
<i>përgjegjës sektori dhe</i>	1
<i>Specialist i nivelit të lartë</i>	2
3. <i>Drejtoria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit</i>	7
<i>Drejtor,</i>	1
<i>Sektori Urbanistikë,</i>	
<i>përgjegjës sektori</i>	1
<i>Specialist i nivelit të lartë</i>	2
<i>Sektori i Turizmit dhe kulturës,</i>	
<i>përgjegjës sektori</i>	1
<i>Specialist i nivelit të lartë,</i>	2
4. <i>Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve,</i>	12
<i>Drejtor,</i>	1
<i>Sektori i Financës,</i>	
<i>përgjegjës sektori</i>	1
<i>Specialist i nivelit të lartë</i>	2
<i>Sektori Juridik dhe Marrëdhënieve me Jashtë,</i>	
<i>përgjegjës sektori</i>	1
<i>Specialist i nivelit të lartë</i>	2
<i>Sektori i Shërbimeve Rajonale, me organikë</i>	
<i>përgjegjës sektori</i>	1
<i>Specialist i nivelit të lartë</i>	4
5. <i>Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore,</i>	6
<i>Drejtor</i>	1
<i>Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Arshivës,</i>	
<i>përgjegjës sektori,</i>	1
<i>Specialist i nivelit të lartë</i>	1
<i>Sektori IT dhe Statistikës,</i>	
<i>përgjegjës sektori</i>	1
<i>Specialist i nivelit të lartë</i>	2
6. <i>Inspektoriati Ndërtimor dhe Urbanistik,</i>	3
<i>Kryeinspektor i Inspektoriatit të Ndërtimit</i>	1
<i>Inspektor i nivelit të lartë</i>	2
7. <i>Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes Tokës</i>	-
<i>(Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës)</i>	4
<i>Kryeinspektor i IMT</i>	1
<i>Inspektor i nivelit të lartë</i>	3

Totali

41 pozicione pune në shërbim civil

Duke krahasuar këto dy struktura, konstatohet se në strukturën e muajit gusht 2014, kemi një shtim të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil me 17 vende.

Nga inspektimi është konstatuar se, pas implementimit të kësaj strukture, institucioni ka pasur gjithsej 21 pozicione të lira, nga këto 16 pozicione në shërbimin civil dhe 5 pozicione me rol mbështetës, administrativ.

- Struktura aktuale, me të cilën ende funksionon edhe në momentin e inspektimit, miratuar me Vendimin nr.32, datë 25.03.2015 “Për miratimin e strukturës organizative dhe klasifikimin e nivelit të ri të pagave të punonësve të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë dhe Ndërrmarrjeve të varësisë”.

Numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës është 22, nga të cilët 15 pozicione i përkasin fushës së veprimit të ligjit për shërbimin civil dhe 7 pozicione pune janë funksione mbështetëse.

Struktura e aparatit të institucionit në këtë rast është e organizuar në këtë mënyrë:

- | | |
|---|----|
| 1. Zyra e Informacionit e kryetarit | |
| <i>Specialist</i> i nivelit të lartë | 1 |
| <i>Specialist</i> i nivelit të mesëm | 1 |
| 2. Sektori i Financës, | 11 |
| Përgjegjës për sektorin e financës | 1 |
| <i>Specialist</i> i nivelit të lartë për shërbimet rajonale | 2 |
| <i>Specialist</i> i nivelit të lartë për shërbimet juridike | 1 |
| <i>Specialist</i> i i nivelit të lartë | |
| për koordinim, hartimin e zbatimin e projekteve | 1 |
| <i>Specialist</i> i nivelit të lartë | 1 |
| për koordinim dhe zbatimin e projektit INAKT | |
| <i>Specialist</i> i i nivelit të lartë për urbanistikën | 1 |
| <i>Specialist</i> i i nivelit të lartë për turizmin dhe kulturën | 2 |
| <i>Specialist</i> i i nivelit të lartë | 1 |
| për menaxhimin e burimeve njerëzore e arshivën | |
| <i>Specialist</i> i i nivelit të mesëm për arshivën dhe protokollin | 1 |
| 3. Inspektor i lartë në inspektoratin ndërtimor urbanistik | 1 |
| 4. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës | - |
| 5. Inspektorati i Mbrojtjes së Tokës | |
| <i>Inspektor</i> i nivelit të lartë në IMT | 1 |

Totali **15 pozicione pune pjesë e shërbimit civil**

Nëse do të shqyrtojmë përmbajtjen e strukturave të paraqitura më sipër, konstatohet se në të gjitha rastet, nuk është i evidentuar numri i punonjësve që janë pjesë e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, pasi është trajtuar si strukturë e veçantë.

Duke analizuar aktet ligjore që rregullojnë veprimtarinë e kësaj strukture, rezulton se, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës funksionon mbi bazën e ligjit nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, ndryshuar me ligjin nr. 10257, datë 25.03.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8752, datë 26.03.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të kësaj strukture parashikohen në nenin 5 dhe 6 të ligjit të sipërcituar ku përcaktohet se, “drejtori dhe specialistët e DAMT-së emërohen dhe shkarkohen në përputhje me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Pra, duke patur parasysh faktin që emërimi i tyre kryhet mbi bazën e një procedure konkurruese, si dhe përfshirjen e këtyre pozicioneve në kategorinë e funksioneve që ushtrojnë autoritet publik, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kjo strukturë duhet të përfshihet në shërbimin civil dhe në strukturën e institucionit.

Konkluzion: Për arsytet e përmendura më sipër, njësia përgjegjëse duhet të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, në mbështetje të kërkesave të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Më tej, nga krahasimi i strukturave të analizuara, rezulton se institucioni ka kaluar në një proces ristrukturimi, në kushtet kur konstatohet plotësimi i dy kërkesave ligjore për të pasur një proces të tillë, së pari shkurtimi i numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe së dyti, ndryshimi i strukturës organizative.

Më poshtë po e trajtojmë në mënyrë tabelare këtë fakt, për të krijuar një përshtypje të qartë, se si është zhvilluar procesi, në vijimësi në periudhën që përfshin vitet 2012 - 2015.

Tabelë: “Transformimi i strukturës së institucionit në periudhën 2012 – 2015”.

1	2	3	4	5	6
Viti	Pozicione pune gjithsej	Pozicione pune në shërbim civil	Drejtor drejtorie	Përgjegjës sektori/ Kryeinspektor	Specialist/ inspektor
Viti 2012	38	24	5	3	17
Viti 2014	56	41	4	11	26
Viti 2015	22	15	-	1	11

II/1. Rregullimi ligjor i procesit të ristrukturimit dhe si ka vepruar institucioni për zbatimin e procedurës që duhet të ndiqet në këtë rast.

Procesi i ristrukturimit fillon të materializohet me miratimin e strukturës së re të institucionit dhe në përmbajtje përbëhet nga të gjitha aktet administrative që realizon njësi përgjegjëse gjatë implementimit të tij, ndër të cilat aktet e krijimit dhe të funksionimit të Komisionit të Ristrukturimit; aktet e lirimimit të nëpunësve që u është deklaruar i tepërt pozicioni i punës; aktet e rrimërimimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit, etj.

Ky proces realizohet nga njësi përgjegjëse, në përmbushje të kërkesave të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar); Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", si dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil" dhe Udhëzimit nr.3, datë 14.04.2014 "Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit" të Departamentit të Administratës Publike, të cilat e kanë vendosur këtë hallkë, në krye të procesit të ristrukturimit, për tu kujdesur edhe në drejtim të anës procedurale ligjore.

Njësi përgjegjëse është struktura që krijon Komisionin e Ristrukturimit dhe pas propozimit të bërë prej këtij mekanizmi, ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për lirimimin nga shërbimi civil, të nëpunësve që i ka dalë i tepërt pozicioni i punës, ose i ka ndryshuar përshkrimi i punës.

Nisur nga verifikimi që grupi i inspektimit i ka bërë procesit të ristrukturimit dhe akteve që e materializojnë atë, rezulton se shkak për përfshirjen e institucionit në këtë proces, ka qenë pakësimi i fondit në buxhetin e institucionit, prej 15% të transfertës së pakushtëzuar për koston e personelit administrativ, në zbatim të nenit 15 të Ligjit 160/2014 "Për buxhetin e vitit 2015".

Për këtë arsye, ky kufizim solli si pasojë edhe ndryshimet në strukturën e këtij institucioni që u materializuan në Vendimin nr.32, datë 25.03.2015 të Këshillit të Qarkut, "Për miratimin e strukturës organizative dhe klasifikimin e nivelit të ri të pagave të punonjësve të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë dhe Ndërmarrjeve të varësisë", e cila u bë funksionale pas konfirmimit të bazueshmërisë ligjore, nga Prefekti i Qarkut Korçë, njoftuar institucionit me shkresën nr. 436/1 prot., datë 14.04.2015.

Në këto kushte, në zbatim të pikës 3 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar) dhe pikës 17 të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil", njësi përgjegjëse duhet të merrte masat për të krijuar Komisionin e Ristrukturimit, me detyrimin për të shqyrtuar mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese, apo transferimin e punonjësit në një pozicion të lirë të së njëjtës kategori.

Për të verifikuar zbatimin e ligjit në lidhje me këtë institut, u kërkua nga institucioni dokumentacioni përkatës, nga shqyrtimi i të cilit, rezulton se nga ana e institucionit është bërë

përpjekje formale për të zbatuar kërkesat e ligjit në këtë rast, por pasi u shqyrtua përmbajtja e akteve që na u vunë në dispozicion konstatohen parregullsi që e bëjnë të cënueshëm të gjithë procesin. Më poshtë po analizojmë me radhë arsyet që argumentojnë këtë përfundim.

Së pari, konstatohet se nuk ka një akt administrativ që të ketë urdhëruar ngritjen dhe përbërjen e Komisionit të Ristrukturimit. Për ekzistencën e këtij mekanizmi, biem në dijeni nëpërmjet një Akt – Konstatimi, me nr. 223 Prot., datë 06.02.2015, nga analiza e përmbajtjes së të cilit, rezulton se Komisioni i Ristrukturimit është i përbërë nga Kryetarja e Këshillit të Qarkut, ****
, Zëvendës Kryetari i Këshillit të Qarkut, ** dhe ***** , me cilësinë e Sekretarit të Këshillit të Qarkut. Edhe nëse do ta konsideronim të mirëqënë krijimin e Komisionit të Ristrukturimit nëpërmjet këtij akti, konstatohet se përbërja e këtij komisioni nuk ka asnjë lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë aspekt. Asnjëri prej këtij grupimi nuk ka lidhje me shërbimin civil, pasi pozicionet e tyre nuk janë pjesë e shërbimit civil, dhe njëkohësisht nuk bëjnë pjesë në subjektet që ngarkon ligji për të realizuar procesin e ristrukturimit.

Së dyti, nga përmbajtja e Akt Konstatimit nr. 223, datë 06.02.2015, rezulton se, nga ana e Komisionit të Ristrukturimit, është disponuar në kushtet kur ende nuk ishte formalizuar ligjërisht struktura e re e institucioit. Ky akt ka marrë formën ligjore, në datën 14.04.2015, pas konfirmimit të ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Korçë, me shkresën nr. nr. 436/I prot., që shënon edhe momentin kur institucionit i lind e drejta të ngrejë Komisionin e Ristrukturimit.

Më tej, konstatohet se Komisioni, pasi ka njoftuar për seancë dëgjimore (*njoftim për kryerjen e bisedimeve që rezulton për të gjithë nëpunësit civil të pezulluar, analizuar rast pas rasti në rubrikën ku trajtohen këta punonjës*) dhe i ka dëgjuar punonjësit, ka analizuar pozicionet e punës së institucionit dhe në përfundim ka konkluduar se në të gjitha drejtoritë do të ketë shkurtime. Për këtë arsye ka konstatuar, "shkakun e pezullimit të nëpunësve civilë", duke përmendur në mënyrë nominale 12 nëpunës civilë, për të cilët do të flasim në mënyrë të hollësishme në vijim të materialit.

Në përfundim, ky Komision ka ngarkuar Kryetaren e Këshillit të Qarkut, për zbatimin e këtij Akt Konstatimi dhe nxjerrjen e urdhërit të pezullimit për secilin prej tyre.

Në zbatim të kësaj detyre, konstatohet një akt tjetër administrativ, nr. 223/1, datë 06.02.2015 "*Vendim*", në këtë rast i nxjerrë nga njësia përgjegjëse, (*me përberje Zëvendës/Kryetarit; Sekretarin e Këshillit të Qarkut dhe një specialist, pra dy anëtarë nuk janë pjesë e shërbimit civil*), nga përmbajtja e të cilit rezulton se, bazuar në Akt – Konstatimin e analizuar më sipër, njësia përgjegjëse ka vendosur pezullimin e 12 nëpunësve civilë. Në këtë akt, është ngarkuar Kryetari i Këshillit të Qarkut për të formalizuar këtë vendim.

Në përfundim të këtij procesi, Kryetarja e Këshillit të Qarkut ka nxjerrë aktet administrative përkatëse, që do të trajtohen nominalisht në vijim të materialit, për 12 nëpunës civilë, duke i pezulluar marrëdhënien e punës.

Nga analiza e përmbajtjes së këtij akti administrativ, rezulton se është përdorur si bazë ligjore neni 54, gërma "e" dhe neni 56, i ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*" (i ndryshuar), dispozita

që rregullojnë institutin e pezullimit për shkak të ligjit, por që në rastin konkret, ristrukturimi i institucionit, nuk është një prej këtyre shkaqeve.

Pra, nga sa analizuam më sipër, konstatohet se në këtë rast ndodhemi në kushtet e zbatimit të gabuar të ligjit nga ana e institucionit, pasi të gjithë mekanizmat që kanë vepruar në këtë proces, si Komisioni i Ristrukturimit, njësia përgjegjëse ashtu edhe Kryetari i Këshillit të Qarkut, kanë vepruar në kundërshtim të hapur me ligjin dhe për këtë arsye, ndodhemi në kushtet e pavlefshmërisë absolute, të parashikuara nga neni 115 e vijues i Kodit të Procedurave Administrative, që passjell pavlefshmëri të të gjitha veprimeve administrative të kryera deri në këtë fazë.

Në këto rrethana, duke qënë se ndodhemi në kushtet e ristrukturimit të institucionit, për të rregulluar ligjshmërinë e procesit, duhet të revokohen të gjitha aktet administrative të analizuara më sipër, që kanë të bëjnë me pezullimin e nëpunësve civilë dhe procesi i ristrukturimit të fillojë nga e para, duke e nisur me krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, me përbërje sipas kërkesave të parashikuara në nenin 50 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

Së treti, konstatohet se, pas miratimit të strukturës së institucionit, pra kur tashmë ndodhemi në rrethana të reja, kur institucioni legjitimohet që të fillojë procedurat e ristrukturimit, ka dalë Urdhëri nr. 36, datë 18.05.2015, i Kryetarit të Këshillit të Qarkut, "Për Ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre administrative për disa nëpunës të Këshillit të Qarkut, për arsye të ristrukturimit të administratës", i cili në përmbajtjen e tij, ka ndërprerë marrëdhënien e punës për 11 nëpunës civilë, të cilët, pas verifikimit, rezultojnë që më parë të kenë qënë të pezulluar, sipas procedurës që analizuam më sipër. Sipas procesverbaleve të administruara në dosjen e inspektimit, këta punonjës në datën 11.05.2015, janë njoftuar për vendimin e Këshillit të Qarkut që ka miratuar strukturën e re.

Në këto kushte, fakti që në këtë rast nuk është kryer asnjë procedurë ligjore, e tillë si ngritja e Komisionit të Ristrukturimit, apo nuk është bërë asnjë përpjekje për të sistemuar nëpunësit civilë sipas precedencës së përcaktuar në pikën 2 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, apo për të kryer verifikimet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ku i kërkohet Komisionit të Ristrukturimit që të shqyrtojë mundësinë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira, nëse i plotëson kërkesat specifike, tregon se nga ana e titullarit të institucionit, është marë si i mirëqenë procesi i kryer më parë, deri në fazën e pezullimit, duke vepruar në këtë mënyrë, haptazi në kundërshtim me procedurat e kërkuara nga ligji, ç'ka në kuptim të neneve 115 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, passjell pavlefshmëri absolute të aktit administrativ nr. 36, datë 18.05.2015 "Për Ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre administrative për disa nëpunës të Këshillit të Qarkut, për arsye të ristrukturimit të administratës".

Këtë konkluzion e mbështet edhe fakti, që aktualisht në 5 raste, të cilat do të trajtohen nominalisht në vijim, para ristrukturimit, janë punësuar punonjës me emërim të përkohshëm, duke mos respektuar procedurat e konkurimit, të cilët janë risistemuar në zbatim të strukturës së re, edhe pse institucioni nuk ka asnjë detyrim ligjor në këtë rast.

Konkluzion: Për të gjitha sa analizuam më sipër, Komisioneri vlerëson se duhet të rregullohet ligjshmëria e veprimeve të kryera gjatë procesit të implementimit të strukturës së re në institucion, pas një procesi ristrukturimi.

Në këtë rast institucioni duhet të revokojë të gjitha aktet administrative që kanë dalë deri në këtë moment në lidhje me këtë proces, sipas rekomandimeve të dhëna me sipër dhe të fillojë procesin nga e para, duke ndjekur këtë rend pune:

a) Ngritja e Komisionit të Ristrukturimit, duke u kujdesur që të respektohen kërkesat ligjore në përbërjen e tij, i cili bazuar në pikën 7 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ka të drejtë të propozojë sistemimin dhe trajtimin financiar për të gjithë nëpunësit të cilët do të largohen për shkak të ristrukturimit, duke karahasuar përshkrimin e punës, kërkesat specifike si dhe çdo kërkesë tjetër që rrjedh nga dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë rast, për çdo pozicion që nuk ekziston më. Në këtë rast duhet të jetë në vëmendjen e njësisë përgjegjëse Udhëzimi nr.3, datë 14.04.2014 i Departamentit të Administratës publike, *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”*, ku përcaktohen qartë rregullat e përgjithëshme për krijimin dhe funksionimin e këtij mekanizmi.

b) Komisioni i Ristrukturimit, të paraqesë propozimet për lirim nga shërbimi civil, të atyre nëpunësve pozicioni i të cilëve nuk ekziston më, apo është riorganizuar, kompetencë e tij që është e parashikuar në pikën 3 të nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe në Vendimin nr.171, datë 26.03.2014 *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”* të Këshillit të Ministrave.

c) Përmbyllja e procesit me vendimin përfundimtar për lirim nga shërbimi civil, apo rrimërimin në pozicione të të njëjtës kategori, sipas dispozitave të mësipërme, që duhet të merret nga njësia përgjegjëse, pasi të analizojë propozimet e Komisionit të Ristrukturimit. Duhet të tregohet kujdes, që në rastet e uljes në detyrë të punonjësit, duhet të merret mendimi i tij me shkrim për pranimin ose refuzimin e pozicionit të ofruar siç përcaktohet në pikën 19 dhe 20, Kreu III *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”*.

d) Hartimi i përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil, sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, që përbën një proces kompleks dhe që është kusht pa të cilin nuk mund të kryhet risistemimi i punonjësve në të njëjtin pozicion, transferimi i tyre apo rregjistrimi i tyre në listën e pritjes. Kjo për faktin se puna e Komisionit të Ristrukturimit është e lidhur me krahasimin e kërkesave specifike për pozicionin e punës, çka është një rubrikë e rëndësishme e që përfshihet në formularin e përshkrimit të punës.

Më poshtë, do të analizojmë mënyrën se si është pasqyruar procesi i ristrukturimit, për çdo punonjës që ka qenë në marrëdhënie pune me institucionin, në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil, në momentin e implementimit të strukturës së re. Në përmbajtjen e çdo rasti,

gjenden edhe argumentat që na kanë shërbyer për të dalë në konkluzionin se nga ana e institucionit, nuk është zbatuar drejt ligji gjatë implementimit të strukturës së re, e cila është shoqëruar me shkurtrim të pozicioneve të punës, që janë pjesë e shërbimit civil.

II/2/a. Situata në lidhje me punonjësit që janë sistemuar në këtë institucion, pas ristrukturimit, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

Më poshtë po paraqesim në mënyrë të detajuar procesin e ristrukturimit, në lidhje me punonjësit që janë përfshirë në këtë proces dhe ende vijojnë të kryejnë funksionet e tyre në këtë institucion.

1. ***** , është emëruar në pozicionin “*Specialist i nivelit të lartë*”, pas ristrukturimit, në Sektorin e koordinimit, hartimit dhe zbatimit të projekteve, që i përket kategorisë së nëpunësit civil të nivelit ekzekutiv, kategoria III-b, me aktin administrativ nr. 22 prot., datë 12.02.2015 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, “*Për emërimin e nëpunësve dhe punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë*”.

Kjo punonjëse ka filluar punë si nëpunëse civile në periudhë prove në këtë institucion, me Urdhërin nr. 100 prot., datë 04.05.2007 “*Për emërimin Specialiste për Projektet Komunitare, në Drejtorinë e Investimeve dhe Shërbimeve në Këshillin e Qarkut Korçë*”, pas përfundimit të procedurave të konkurimit, në zbatim të ligjit nr. 8459 datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*” dhe është konfirmuar si nëpunëse civile me Urdhërin nr. 33, datë 30.05.2008 “*Për konfirmimin si nëpunës civil*”, në të njëjtin pozicionin pune.

Konstatohet se njësia përgjegjëse ka nxjerrë Aktin e Deklarimit të Statusit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, (i ndryshuar), për këtë punonjëse, duke e klasifikuar në kategorinë e nëpunësit civil, me aktin administrativ nr. 28, datë 12.05.2014.

Duke e krahasuar pozicionimin e saj pas ristrukturimit, rezulton se para ristrukturimit kjo nëpunëse ka qenë në të njëjtin pozicion pune, ku është emëruar rishtaz në shërbimin civil.

Nisur nga përmbajtja e aktit të transferimit të kësaj punonjëseje, për shkak të ristrukturimit, vihet re se është vendosur një klauzolë që e lidh marrëdhënien e punës me një kusht, deri në përfundim të procedurave të konkurimit.

Ky kufizim vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” (i ndryshuar), i cili bën fjalë për transferim të përhershëm të nëpunësit civil, i cili kryhet me propozimin e Komisionit të Ristrukturimit dhe me miratimin e njësisë përgjegjëse dhe nuk është i lidhur me asnjë kusht tjetër.

Në këto rrethana, pas përmbjlljes së procedurës së ristrukturimit nga njësia përgjegjëse, marrëdhënia juridike e punës dhe ajo financiare, vazhdon të ekzistojë pa asnjë kufizim.

2. ***** , është emëruar me aktin administrativ nr. 22 prot., datë 12.02.2015 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut “*Për emërimin e nëpunësve dhe punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë*”, pas ristrukturimit, në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Financës*”, që i përket klasës nëpunës civil i nivelit ulët drejtues, kategoria III-a/1.

Kjo punonjëse ka filluar marrëdhënien e punës me institucionin, me Urdhërin nr. 4, datë 09.03.2001 "Për emërimin Përgjegjëse e Sektorit të Financës në Këshillin e Qarkut Korçë", me kalimin nga një institucion tjetër. Me vendimin nr. 98, datë 10.03.2003, është emëruar në pozicionin "Drejtoresh e Financës", si pasojë e zbatimit të Urdhërit nr. 19, datë 25.03.2003 "Për ndryshimin e emërtimeve sipas struktureve të reja të miratuar nga Këshilli i Qarkut Korçë".

Konstatohet se njëzia përgjegjëse ka nxjerrë Aktin e Deklarimit të Statusit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), për këtë punonjëse, duke e klasifikuar në kategorinë e nëpunësit civil, me aktin administrativ nr. 35, datë 12.05.2014.

Edhe në këtë rast konstatohet se është vendosur një klauzolë që e lidh marrëdhënien e punës me një kusht, deri në përfundim të procedurave të konkurimit dhe për këtë arsye vlen i njëjti arsyetim që është bërë më sipër, e që e vlerëson këtë veprim si në kundërshtim me ligjin.

3. ***** , është emëruar me aktin administrativ nr. 22, datë 12.02.2015 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut "Për emërimin e nëpunësve dhe punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë", pas rristurimit, në pozicionin "Specialist i nivelit të lartë", në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale, që i përket klasës së nëpunësit civil të nivelit ekzekutiv, kategoria III-b.

Ky punonjës ka filluar punë me Urdhërin nr. 6, datë 28.01.2010 "Për emërimin Specialist për Kërkim Zhvillimin në Këshillin e Qarkut Korçë", me kontratë të përkohshme, deri në zhvillimin e konkurimit. Me Urdhërin nr. 22, datë 02.05.2011, pas përfundimit të procedurës së konkurimit, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin "Specialist i Kërkim Zhvillimit", në Drejtorinë e Investim Shërbimeve. Me Urdhërin nr. 37, datë 26.11.2012 "Për konfirmimin si nëpunës civil", është konfirmuar në pozicionin e mësipërm.

Konstatohet se njëzia përgjegjëse ka nxjerrë Aktin e Deklarimit të Statusit të Punësimit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), për këtë punonjës, duke e klasifikuar në kategorinë e nëpunësit civil, me aktin administrativ nr. 33, datë 12.05.2014.

Edhe në këtë rast, konstatohet se është vendosur një klauzolë që e lidh marrëdhënien e punës me një kusht, deri në përfundim të procedurave të konkurimit dhe për këtë arsye, vlen i njëjti arsyetim që është bërë më sipër, e që e vlerëson këtë veprim, si në kundërshtim me ligjin.

4. ***** , është emëruar me aktin administrativ nr. 22 prot., datë 12.02.2015 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut "Për emërimin e nëpunësve dhe punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë", pas rristurimit, në pozicionin "Inspektor i nivelit të lartë në IMT" që i përket klasës së nëpunësit civil i nivelit ekzekutiv, kategoria III-b.

Ky punonjës ka filluar punë me urdhrin nr. 41, prot., datë 22.05.2006 "Për emërimin në Seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Korçë të nëpunësit *****", nëpërmjet procedurave të konkurimit është përzgjedhur nga titullari, nëpunës civil në periudhë prove. Me urdhrin nr. 78 dt. 01.02.2007, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me pozicionin e specialistit pranë seksionit të Mbrojtjes së Tokës dhe është emëruar në pozicionin e punës

“Kryeinspektor” i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës, në Këshillin e Qarkut Korçë, duke mos respektuar procedurat e konkurimit. Më pas rezultoi se është konfirmuar si nëpunës civil me Urdhërin nr. 139 dt. 03.10.2007 të titullarit të institucionit.

Pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), konstatohet se i është deklaruar statusi i punësimit nga njësi përgjegjëse, me aktin administrativ nr. 17, datë 12.05.2014, si nëpunës civil në pozicionin “Kryeinspektor” në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës.

Edhe në këtë rast, konstatohet se është vendosur një klauzolë që e lidh marrëdhënien e punës me afat(kusht), deri në përfundim të procedurave të konkurimit dhe për këtë arsye, vlen i njëjti arsyetim që është bërë më sipër, për këtë kategori të punonjësve, duke e vlerësuar këtë qëndrim si në kundërshtim me ligjin.

5. ***** , është emëruar në institucion me Urdhërin nr. 13, datë 03.03.2008 “Për emërimin me kontratë të përkohshme në pozicionin, Inspektor Ndërtimor Urbanistik në Këshillin e Qarkut Korçë”.

Me Urdhërin nr. 23, datë 02.05.2008, emërohet në pozicionin “Inspektor në Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik të Qarkut Korçë”, si nëpunës civil në periudhë prove, rekrutuar sipas procedurave të rekrutimit në shërbimin civil, të përcaktuar në ligjin nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Me Urdhërin nr. 41, datë 26.11.2012 “Për konfirmimin si nëpunës civil të *****” konfirmohet si nëpunës civil.

Më pas, nisur nga fakti se ky pozicion pune, nuk rregullohej sipas ligjit nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil”, (tashmë i shfuqizuar), pasi në ligjin specifik për urbanistikën, parashikohej se statusin e nëpunësit civil, e gëzonin vetëm punonjësit e Inspektoratit Kombëtar të Urbanistikës, me Urdhërin nr. 26, datë 19.12.2013 “Për revokimin e urdhrin nr. 41, datë 26.11.2012, si dhe anulimin e gjithë procedurës së konkurimit të *****”, nga ana e institucionit janë revokuar procedurat e konkurimit, pasi ky proces nuk ishte i detyrueshëm për këtë pozicion pune dhe marrëdhënia e punës ka vazhduar e pa ndërprerë, por tashmë e rregulluar sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Pas fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, si pasojë e zgjerimit të fushës së shërbimit civil, duhet të përfshihen në skemën e shërbimit civil edhe pozicionet e punës që bëjnë pjesë në strukturën e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik të Këshillit të Qarkut.

Kjo për faktin se në nenin 2 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është parashikuar në mënyrë të shprehur se, fusha e veprimit të ligjit, shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore.

Në këto rrethana, duke patur parasysh faktin se këto pozicione përfshihen në kategorinë e funksioneve që ushtrojnë autoritet publik në një njësi të qeverisjes vendore, që është Këshilli i Qarkut, Korçë, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kjo strukturë duhet të përfshihet në shërbimin civil dhe për pasojë marrëdhëniet e punës duhet të rregullohen sipas ligjit për nëpunësin civil.

Në këto kushte ky rast përfshihet në kategorinë e punonjësve që fillimi i efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil i ka gjetur në një pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil, për një periudhë mbi 1 (një) vit.

Aktualisht, punonjësi ***** , rezulton i ripozicionuar në strukturën e re të institucionit, me Urdhërin nr. 22, datë 12.02.2015 "Për emërimin e nëpunësve dhe punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë, në pozicionin "Inspektor i nivelit të lartë", në Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik.

Njësia përgjegjëse duhet të përfundojë procesin e verifikimit të statusit të punësimit sipas kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar) dhe në përfundim të deklarojë statusin e punësimit, sipas kësaj dispozite, me qëllim që të ketë mundësi të pozicionojë këtë punonjës pas ristrukturimit.

II/2/b. Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohëshme emërimi, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar), të cilët janë sistemuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, pas ristrukturimit.

Pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, konstatohet se, në këtë institucion, në kundërshtim me ligjin, janë emëruar punonjës me akte emërimi të përkohshme në 5 raste dhe konkretisht, bëhet fjalë për pozicionet të cilët po i trajtojmë më hollësisht në vijim:

1. ***** , është emëruar si punonjëse e Këshillit të Qarkut Korçë, me Urdhërin nr. 65, datë 16.10.2014, të titullarit të institucionit, "Për emërim punonjësi të *****",

Kjo punonjëse ka filluar punë në pozicionin "Specialist", pranë Drejtorisë së Koordinimit të Politikave të Qarkut në Këshillin e Qarkut Korçë, një vend pune i krijuar rishtaz me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 15, datë 30.08.2014 të Këshillit të Qarkut Korçë, "Për miratimin e strukturës organizative dhe klasifikimin e nivelit të ri të pagave të punonësve të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë".

Nga përmbajtja e aktit të emërimit, rezulton se është vepruar në këtë mënyrë, duke e justifikuar daljen e aktit me nevojat emergjente të institucionit, për të mos penguar ecurinë e punës.

Pra, nga sa parashtruar, rezulton se momenti i fillimit të efekteve të ligjit, (data 26.02.2014), nuk e ka gjetur këtë punonjëse në marrëdhënie pune me institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë, e për pasojë, ajo nuk e gëzon të drejtën për t'u trajtuar si nëpunëse civile.

Megjithatë, ky fakt nuk është marrë parasysh nga njësia përgjegjëse, në kushtet kur kjo punonjëse, është sistemuar përsëri pas ristrukturimit, me Urdhërin nr. 22, datë 12.02.2015, të titullarit të institucionit, "Për emërimin e nëpunësve dhe punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë", sipas strukturës së re të miratuar me Vendimin nr.32 datë 25.03.2015 "Për miratimin e strukturës organizative dhe klasifikimin e nivelit të ri të pagave të punonësve të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë dhe Ndërmarrjeve të varësisë", në pozicionin

"Specialist i nivelit të Lartë", në Sektorin e Koordinimit, Hartimit, Zbatimit të Projekteve, edhe pse, me një afat të lidhur tashmë me përfundimin e procedurave të konkurimit.

Nisur nga sa më sipër, institucioni nuk ka asnjë detyrim ligjor që të sistemojë këtë punonjëse pas ristrukturimit, në këtë pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil.

Pozicioni i punës ku aktualisht është e sistemuar punonjësja ***** , fillimisht duhet të trajtohet nga Komisioni i Ristrukturimit për të sistemuar nëpunësit e institucionit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe nëse në asnjë rast nuk plotësohen prej tyre kërkesat për këtë vend pune, atëherë ky pozicion duhet të shpallet si i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit, sipas përcaktimit të neneve 23 dhe 24 të ligjit 152/2013, *"Për nëpunësin civil"* (i ndryshuar) dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave, *"Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive"*.

2. ***** , ka filluar punë si punonjëse e Këshillit të Qarkut Korçë, me Urdhërin nr. 73, datë 07.11.2014 të titullarit të institucionit, me emërim të përkohshëm, në pozicionin *"nëpunës për marrëdhëniet me shtypin"* (në strukturë specialiste), pranë zyrës së kryetarit, duke mos respektuar procedurat e konkurimit.

Nisur nga momenti i emërimit, rezulton se fillimi i efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil (data 26.02.2014), nuk e ka gjetur këtë punonjëse në ndonjë pozicion pune, pjesë e shërbimit civil, pranë institucionit të Këshillit të Qarkut, e për pasojë, ajo nuk e gëzon të drejtën për t'u trajtuar si nëpunëse civile.

Megjithatë, ky fakt nuk është marrë parasysh nga njësia përgjegjëse, në kushtet kur kjo punonjëse, është sistemuar përsëri pas ristrukturimit, me Urdhërin nr. 22 datë 12.02.2015 *"Për emërimin e nëpunësve dhe punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë"*, sipas strukturës së re të miratuar me Vendimin nr.32 datë 25.03.2015 *"Për miratimin e strukturës organizative dhe klasifikimin e nivelit të ri të pagave të punonësve të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë dhe Ndërmarrjeve të varësisë"*, në pozicionin, *"Specialist i Nivelit të Lartë në Sektorin e Turizmit dhe Kulturës në Këshillin e Qarkut Korçë edhe pse, me një afat të lidhur tashmë me përfundimin e procedurave të konkurimit.*

Nisur nga sa më sipër, institucioni nuk ka asnjë detyrim ligjor që të sistemojë këtë punonjëse pas ristrukturimit, në këtë pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil.

Pozicioni i punës ku aktualisht është e sistemuar punonjësja ***** , fillimisht duhet të trajtohet nga Komisioni i Ristrukturimit për të sistemuar nëpunësit e institucionit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe nëse në asnjë rast nuk plotësohen prej tyre kërkesat për këtë vend pune, atëherë ky pozicion duhet të shpallet si i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit, sipas përcaktimit të neneve 23 dhe 24 të ligjit 152/2013, *"Për nëpunësin civil"* (i ndryshuar) dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave, *"Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive"*.

3. ***** , është emëruar pranë Këshillit të Qarkut Korçë me Urdhërin nr. 28, datë 24.09.2014, të titullarit të institucionit, në pozicionin *"Specialist"*, në Drejtorinë e

Investim Shërbimeve në Këshillin e Qarkut Korçë, duke mos respektuar procedurat e konkurimit, por nëpërmjet emërimit të përkohshëm, të lidhur me afatin e zhvillimit të procedurave të rekrutimit.

Nga përmbajtja e aktit të emërimit, rezulton se është vepruar në këtë mënyrë, duke e justifikuar daljen e aktit me nevojat emergjente të institucionit, për të mos penguar ecurinë e punës.

Pra, nga sa parashtruam, rezulton se momenti i fillimit të efekteve të ligjit, (data 26.02.2014), nuk e ka gjetur këtë punonjës në marrëdhënie pune me institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë, e për pasojë, ai nuk e gëzon të drejtën për t'u trajtuar si nëpunës civil.

Megjithatë, ky fakt nuk është marrë parasysh nga njësia përgjegjëse, në kushtet kur ky punonjës, është sistemuar përsëri pas ristrukturimit, me Urdhërin nr. 22, datë 12.02.2015, të titullarit të institucionit, "Për emërimin e nëpunësve dhe punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë", sipas strukturës së re të miratuar me Vendimin nr.32 datë 25.03.2015 "Për miratimin e strukturës organizative dhe klasifikimin e nivelit të ri të pagave të punonjësve të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë dhe Ndërmarrjeve të varësisë", në pozicionin "Specialist i Nivelit të Lartë", në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale.

Nisur nga sa më sipër, institucioni nuk ka asnjë detyrim ligjor që të sistemojë këtë punonjës pas ristrukturimit, në këtë pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil.

Pozicioni i punës ku aktualisht është i sistemuar punonjësi ***** , fillimisht duhet të trajtohet nga Komisioni i Ristrukturimit për të sistemuar nëpunësit e institucionit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe nëse në asnjë rast nuk plotësohen prej tyre kërkesat për këtë këtë vend pune, atëherë ky pozicion duhet të shpallet si i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit, sipas përcaktimit të neneve 23 dhe 24 të ligjit 152/2013, "Për nëpunësin civil" (i ndryshuar) dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive".

4. ***** , ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Korçë, me Urdhërin nr. 45, datë 26.06.2014, të titullarit të institucionit, "Për emërimin punonjësi", në pozicionin "Specialist i Shërbimeve të Brendshme", duke mos respektuar procedurat e konkurimit, por nëpërmjet emërimit të përkohshëm, të lidhur me afatin e zhvillimit të procedurave të rekrutimit.

Nga përmbajtja e aktit të emërimit, rezulton se është vepruar në këtë mënyrë, duke e justifikuar daljen e aktit me nevojat emergjente të institucionit, për të mos penguar ecurinë e punës.

Ndërkohë, në këtë rast janë konstatuar nga grupi i punës, 3 akte administrative, të dala më pas emërimit fillestar, që janë urdhëra të titullarit të institucionit, të cilët kanë dalë në të njëjtën datë dhe që rregullojnë aspekte të ndryshme të marrëdhënies së punës, që konkretisht janë:

- Urdhëri nr. 46, datë 03.10.2014 "Për kalim kompetencash", me të cilin është emëruar si përgjegjës në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore;

- Urdhëri nr. 51, datë 03.10.2014, "*Për zgjidhjen e kontratës së punës me marreveshje me punonjës të ******";
- Urdhëri nr. 52, datë 03.10.2014 "*Per emerimin ne nje detyre tjetere te ******" me të cilin është emëruar si specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, i cili është edhe pozicioni në të cilin është emëruar fillimisht në këtë institucion.

Pra, nga sa parashtruam, rezulton se momenti i fillimit të efekteve të ligjit, (data 26.02.2014), nuk e ka gjetur këtë punonjës në marrëdhënie pune me institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë, e për pasojë, ai nuk e gëzon të drejtën për t'u trajtuar si nëpunës civil.

Megjithatë, ky fakt nuk është marrë parasysh nga njësia përgjegjëse, në kushtet kur ky punonjës, është sistemuar përsëri pas ristrukturimit, me Urdhërin nr. 22, datë 12.02.2015, të titullarit të institucionit, "*Për emërimin e nëpunësve dhe punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë*", sipas strukturës së re të miratuar me Vendimin nr.32 datë 25.03.2015 "*Për miratimin e strukturës organizative dhe klasifikimin e nivelit të ri të pagave të punonësve të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë dhe Ndërrmarrjeve të varësisë*", në pozicionin, "*specialist i nivelit të lartë*", në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

Nisur nga sa më sipër, institucioni nuk ka asnjë detyrim ligjor që të sistemojë këtë punonjës pas ristrukturimit, në këtë pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil.

Pozicioni i punës ku aktualisht është i sistemuar punonjësi ***** , fillimisht duhet të trajtohet nga Komisioni i Ristrukturimit për të sistemuar nëpunësit e institucionit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe nëse në asnjë rast nuk plotësohen prej tyre kërkesat për këtë këtë vend pune, atëherë ky pozicion duhet të shpallet si i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit, sipas përcaktimit të neneve 23 dhe 24 të ligjit 152/2013, "*Për nëpunësin civil*" (i ndryshuar) dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave, "*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*".

5. ***** , ka filluar punë pranë Këshillit të Qarkut Korçë me Urdhërin nr. 58, datë 09.10.2014, të titullarit të institucionit, në kundërshtim me ligjin nëpërmjet emërimit të përkohshëm, në pozicionin "nëpunës për protokoll arkivin", që rezulton nga përmbajtja e aktit të emërimit, ndërkohë që në strukturë nuk ekziston një pozicion i tillë, por parashikohet pozicioni "*Specialist i nivelit të mesëm për arkivën dhe protokollin*".

Nisur nga momenti i emërimit, rezulton se fillimi i efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil (data 26.02.2014), nuk e ka gjetur këtë punonjës në ndonjë pozicion pune, pjesë e shërbimit civil, pranë institucionit të Këshillit të Qarkut, e për pasojë, ajo nuk e gëzon të drejtën për t'u trajtuar si nëpunës civil.

Megjithatë, ky fakt nuk është marrë parasysh nga njësia përgjegjëse, në kushtet kur kjo punonjës, është sistemuar përsëri pas ristrukturimit, me Urdhërin nr. 22 datë 12.02.2015 "*Për emërimin e nëpunësve dhe punonjësve të administratës së Këshillit të Qarkut Korçë*", sipas strukturës së re të miratuar me Vendimin nr.32 datë 25.03.2015 "*Për miratimin e strukturës*

organizative dhe klasifikimin e nivelit të ri të pagave të punonësve të Administratës së Këshillit të Qarkut Korçë dhe Ndërrmarrjeve të varësisë”, në pozicionin, “nëpunëse për protokoll arkivën” (ne strukturë specialiste), në Këshillin e Qarkut Korçë edhe pse, me një afat të lidhur tashmë me përfundimin e procedurave të konkurimit.

Nisur nga sa më sipër, institucioni nuk ka asnjë detyrim ligjor që të sistemojë këtë punonjëse pas ristrukturimit, në këtë pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil.

Pozicioni i punës ku aktualisht është e sistemuar punonjësja ***** , fillimisht duhet të trajtohet nga Komisioni i Ristrukturimit për të sistemuar nëpunësit e institucionit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe nëse në asnjë rast nuk plotësohen prej tyre kërkesat për këtë vend pune, atëherë ky pozicion duhet të shpallet si i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit, sipas përcaktimit të neneve 23 dhe 24 të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”(i ndryshuar) dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Konkluzion: Komisioneri, pasi analizoi me hollësi të gjithë historikun e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, vlerëson se aktet e emërimit për punonjësit e përmendur më sipër, kanë dalë në kundërshtim me ligjin, pasi për çdo marrëdhënie të re pune, që lidhet pas fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhen respektuar rregullat e këtij ligji.

Plotësimi rishtaz i pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil bëhet në bazë të nenit 22 dhe 23 të tij, e për pasojë duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt konkurrimi. Në nenin 23 “Emërimi në shërbimin civil”, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, (i ndryshuar), parashikohet në mënyrë të shprehur se, “Çdo emërim në pozicion ekzekutiv, në kundërshtim me këtë nen, është absolutisht i pavlefshëm”.

Në këtë rast, rekomandohet njësi përgjegjëse, që për rregullimin e situatës, të revokojë aktet e emërimit për punonjësit e sipërpërmendur dhe të vijojë me procedurat e plotësimit të tyre duke ndjekur këtë rend:

Së pari, Komisioni i Ristrukturimit të bëjë krahasimin e kërkesave të punës për këto pozicione, nëse përputhen me kriteret që plotësojnë punonjësit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe që janë prekur nga procesi i ristrukturimit.

Së dyti, në rast se asnjë nga këta punonjës nuk i plotëson kriteret për t’u punësuar në këto pozicione, atëherë të shpallen si pozicione të lira dhe të vijojnë procedurat për plotësimin e tyre në përputhje me ligjin.

II/2/c. Nëpunës civilë të pezulluar dhe më pas të liruar, pas procesit të ristrukturimit.

Në këtë rubrikë do të paraqesim rastet e punonjësve që janë pezulluar e më pas janë liruar nga shërbimi civil, me pretendimin se pozicionet e punës janë deklaruar të tepërta, për shkak të ristrukturimit.

1. ***** , gëzon statusin e nëpunësit civil në nivelin ekzekutiv, në pozicionin e punës "Specialist i Lartë", në Drejtorinë e Financës, e cila ka filluar punë në Institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë me Urdhërin nr. 6, datë 14.03.2001 të titullarit të institucionit, në pozicionin "specialist në seksionin juridik dhe marrëdhënieve me jashtë" dhe është konfirmuar në këtë pozicion me Urdhërin nr. 60, datë 16.04.2002.

Më tej, rezulton se me Urdhërin nr. 17, datë 25.03.2003, është emëruar në pozicionin "pergjegjës në sektorin e kontrollit të kontabilitetit", në Drejtorinë e Financës.

Ndërkohë, konstatohet se statusi i punësimit është deklaruar me aktin administrativ nr. 36, datë 12.05.2014, në pozicionin "Specialist" në Drejtorinë e Financës.

Nga verifikimi i materialeve të administruara në dosjen e personelit, rezulton se me Urdhërin nr.19, datë 10.02.2015, të titullarit të institucionit, kjo punonjëse është pezulluar nga shërbimi civil me motivacionin, "për shkak të ligjit", ç'ka del nga përmbajtja e akteve administrative që kanë dalë në këtë rast prej Komisionit të Ristrukturimit, si "Njoftimi për kryerjen e bisedimeve", që i përket akti me nr. 165 prot., datë 02.02.2015, si dhe procesverbali me nr. 184 prot, datë 04.02.2015.

Konstatohet se është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe ajo financiare, me aktin administrativ nr. 36, datë 18.05.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre administrative për disa nëpunës të Këshillit të Qarkut, për arsye të ristrukturimit të administratës."

2. ***** , është një nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv, në pozicionin e punës "Specialist i Mesëm", në Drejtorinë e Financës, e cila ka filluar punë në Këshillin e Qarkut Korçë, fillimisht me Urdhërin nr. 14, datë 06.11.2006, në pozicionin e punës ekonomiste, në Drejtorinë e Financës

Më tej, me Urdhërin nr. 75, datë 28.09.2009, emerohet në pozicionin e punës "specialist i lartë", në Drejtorinë e Financës dhe më pas, me Urdhërin nr. 21, datë 02.05.2011, emërohet "Specialiste", në drejtorinë e financës, ku edhe është konfirmuar në të njëjtin pozicion, nëpërmjet Urdhërit nr. 38, datë 26.11.2012.

Konstatohet se kjo punonjëse është deklaruar si nëpunëse civile, me aktin administrativ nr. 34, datë 12.05.2014, në pozicionin e punës "specialist", në drejtorinë e financës.

Nga verifikimi i materialeve të administruara në dosjen e personelit, rezulton se me Urdhërin nr.20, datë 10.02.2015, të titullarit të institucionit, kjo punonjëse është pezulluar nga shërbimi civil me motivacionin, "për shkak të ligjit", ç'ka del nga përmbajtja e akteve administrative që kanë dalë në këtë rast prej Komisionit të Ristrukturimit, si "Njoftimi për kryerjen e bisedimeve", që i përket akti me nr. 163 prot., datë 02.02.2015, si dhe procesverbali me nr. 183 prot, datë 04.02.2015.

Konstatohet se është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe ajo financiare, me aktin administrativ nr. 36, datë 18.05.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të

punës dhe atyre administrative për disa nëpunës të Këshillit të Qarkut, për arsye të ristrukturimit të administratës."

3. ***** , është nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv, me detyrë "Specialist i Lartë", në Drejtorinë e Investim Shërbimeve, e cila ka filluar punë në Këshillin e Qarkut Korçë, me Urdhërin nr. 4, datë 09.03.2001, në pozicionin "specialist", në seksionin e urbanistikës, konfirmuar në të njëjtin pozicion, sipas Urdhërit nr. 60, datë 16.04.2002.

Konstatohet se me aktin administrativ nr. 31, datë 12.05.2014, është deklaruar statusi i punësimit si nëpunëse civile në pozicionin e punës "Specialist", në Drejtorinë e Investim Shërbimeve.

Nga verifikimi i materialeve të administruara në dosjen e personelit, rezulton se me Urdhërin nr.18 datë 10.02.2015, të titullarit të institucionit, kjo punonjëse është pezulluar nga shërbimi civil me motivacionin, "për shkak të ligjit", ç'ka del nga përmbajtja e akteve administrative që kanë dalë në këtë rast prej Komisionit të Ristrukturimit, si "Njoftimi për kryerjen e bisedimeve", që i përket akti me nr. 160 prot., datë 02.02.2015, si dhe procesverbali me nr. 185 prot, datë 04.02.2015.

Konstatohet se është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe ajo financiare, me aktin administrativ nr. 36, datë 18.05.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre administrative për disa nëpunës të Këshillit të Qarkut, për arsye të ristrukturimit të administratës."

4. ***** , është nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv, në pozicionin "Specialist i Lartë", në Drejtorinë e Investim Shërbimeve, e cila ka filluar punë në Këshillin e Qarkut Korçë, me Urdhërin nr. 4, datë 09.03.2001, në pozicionin "Specialist" në Seksionin e Shërbimeve Rajonale, ku edhe është konfirmuar si nëpunëse civile me aktin administrativ nr. 60, datë 16.04.2002.

Konstatohet se me aktin administrativ nr. 31, datë 12.05.2014, është deklaruar statusi i punësimit si nëpunëse civile në pozicionin e punës "Specialist", në Drejtorinë e Investim Shërbimeve.

Nga verifikimi i materialeve të administruara në dosjen e personelit, rezulton se me Urdhërin nr.17, datë 10.02.2015, të titullarit të institucionit, kjo punonjëse është pezulluar nga shërbimi civil me motivacionin, "për shkak të ligjit", ç'ka del edhe nga përmbajtja e akteve administrative që kanë dalë në këtë rast prej Komisionit të Ristrukturimit, si "Njoftimi për kryerjen e bisedimeve", që i përket akti me nr. 161 prot., datë 02.02.2015, si dhe procesverbali me nr. 190 prot, datë 04.02.2015.

Konstatohet se është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe ajo financiare, me aktin administrativ nr. 36, datë 18.05.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre administrative për disa nëpunës të Këshillit të Qarkut, për arsye të ristrukturimit të administratës."

5. ***** , është nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, në pozicionin e punës "Specialist", në Drejtorinë e Investim Shërbimeve, i cili ka filluar marrëdhëniet e punës

në këtë institucion me aktin administrativ nr. 31, datë 19.07.2012, në pozicionin "Specialist" në Zyrën e Shërbimeve Publike, në Drejtorinë e Investim Shërbimeve.

Konstatohet se me aktin administrativ nr. 18, datë 12.05.2014, është deklaruar statusi i punësimit si nëpunës civil në pozicionin e punës "Specialist", në Drejtorinë e Investim Shërbimeve.

Nga verifikimi i materialeve të administruara në dosjen e personelit, rezulton se me Urdhërin nr.16, datë 10.02.2015, të titullarit të institucionit, ky punonjës është pezulluar nga shërbimi civil me motivacionin, "për shkak të ligjit", ç'ka del nga përmbajtja e akteve administrative që kanë dalë në këtë rast prej Komisionit të Ristrukturimit, si "Njoftimi për kryerjen e bisedimeve", që i përket akti me nr. 162 prot., datë 02.02.2015, si dhe procesverbali datë 06.02.2015.

Konstatohet se është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe ajo financiare, me aktin administrativ nr. 36, datë 18.05.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre administrative për disa nëpunës të Këshillit të Qarkut, për arsye të ristrukturimit të administratës."

6. ***** , është nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, në pozicionin e punës "Drejtor", në Drejtorinë e Projekteve Komunitare, i cili është emëruar në këtë institucion me aktin administrativ nr. 127, datë 16.07.2007.

Konstatohet se me aktin administrativ nr. 15, datë 12.05.2014, është deklaruar statusi i punësimit si nëpunës civil në pozicionin e punës "Drejtor", në Drejtorinë e Projekteve Komunitare.

Nga verifikimi i materialeve të administruara në dosjen e personelit, rezulton se me Urdhërin nr.15, datë 10.02.2015, të titullarit të institucionit, ky punonjës është pezulluar nga shërbimi civil me motivacionin, "për shkak të ligjit", ç'ka del nga përmbajtja e akteve administrative që kanë dalë në këtë rast prej Komisionit të Ristrukturimit, si "Njoftimi për kryerjen e bisedimeve", që i përket akti me nr. 159 prot., datë 02.02.2015, si dhe procesverbali me nr. 186, datë 04.02.2015.

Në këtë rast, konstatohet se me Urdhërin nr. 30, datë 19.03.2015, ky punonjës është emëruar në pozicionin e punës "Specialist", në zyrën e infomacionit të kryetarit, sipas një kontrate që mban datën 19.03.2015 dhe për këtë arsye nuk ndodhet në listën e nëpunësve civilë, të cilëve i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe ajo financiare me aktin administrativ nr. 36, datë 18.05.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre administrative për disa nëpunës të Këshillit të Qarkut, për arsye të ristrukturimit të administratës."

7. ***** , është nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, në pozicionin e punës "Specialist i lartë", në Drejtorinë e Urbanistikës, i cili ka filluar marrëdhëniet e punës me këtë institucion sipas Urdhërit nr. 4, datë 09.03.2001, si "Specialist", në Seksionin e Urbanistikës, ku edhe është konfirmuar si nëpunës civil me aktin nr. 60, datë 16.04.2002.

Konstatohet se, sipas Urdhërit nr. 17, datë 25.03.2003, ka kaluar në pozicionin e punës "përgjegjës", në Sektorin e Planifikimit Urban, në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe më tej, me

Urdhërin nr. 85, datë 23.09.2010, është emëruar Drejtor, i komanduar, i Drejtorisë së Urbanistikës.

Në këtë rast, nuk është evidentuar akti i deklarimit të statusit të punësimit, për këtë arsye njësia përgjegjëse duhet të vijojë procedurën për të përmbyllur procesin e deklarimit të statusit të punësimit.

Nga verifikimi i materialeve të administruara në dosjen e personelit, rezulton se me Urdhërin nr.12, datë 10.02.2015, të titullarit të institucionit, ky punonjës është pezulluar nga shërbimi civil me motivacionin, "për shkak të ligjit", ç'ka del nga përmbajtja e akteve administrative që kanë dalë në këtë rast prej Komisionit të Ristrukturimit, si "Njoftimi për kryerjen e bisedimeve", që i përket akti me nr. 156 prot., datë 02.02.2015, si dhe procesverbali me nr. 187, datë 06.02.2015.

Konstatohet se është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe ajo financiare, me aktin administrativ nr. 36, datë 18.05.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre administrative për disa nëpunës të Këshillit të Qarkut, për arsye të ristrukturimit të administratës."

8. ***** , është nëpunës civil i nivelit ekzekutiv me detyrë "specialist", në Drejtorinë e Urbanistikës, emëruar për herë të parë në institucion me Urdhërin nr. 3, datë 10.01.2013, në pozicionin "specialist", në Zyrën e Urbanistikës.

Konstatohet se me aktin administrativ nr. 20, datë 12.05.2014, është deklaruar statusi i punësimit, si nëpunës civil në pozicionin e punës "specialist", në Zyrën e Urbanistikës.

Nga verifikimi i materialeve të administruara në dosjen e personelit, rezulton se me Urdhërin nr.14, datë 10.02.2015, të titullarit të institucionit, ky punonjës është pezulluar nga shërbimi civil me motivacionin, "për shkak të ligjit", ç'ka del nga përmbajtja e akteve administrative që kanë dalë në këtë rast prej Komisionit të Ristrukturimit, si "Njoftimi për kryerjen e bisedimeve", që i përket akti me nr. 154 prot., datë 02.02.2015, si dhe procesverbali me nr. 189, datë 04.02.2015.

Konstatohet se është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe ajo financiare, me aktin administrativ nr. 36, datë 18.05.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre administrative për disa nëpunës të Këshillit të Qarkut, për arsye të ristrukturimit të administratës."

9. ***** , është nëpunëse civile e nivelit ekzekutiv, në pozicionin e punës "Specialist i Lartë", në Drejtorinë Juridike dhe Personelit, e cila ka filluar punë në Këshillin e Qarkut Korçë, sipas Urdhërit nr. 56, datë 09.07.2002, në pozicionin "Inspektor", në Seksionin e Programim Zhvillimit, ku edhe është konfirmuar me aktin administrativ nr. 39 dt. 05.09.2003.

Konstatohet se me aktin administrativ nr. 29, datë 12.05.2014, është deklaruar statusi i punësimit, si nëpunës civil në pozicionin e punës "specialist", në Zyrën e Urbanistikës.

Nga verifikimi i materialeve të administruara në dosjen e personelit, rezulton se me Urdhërin nr.13, datë 10.02.2015, të titullarit të institucionit, ky punonjës është pezulluar nga shërbimi civil me motivacionin, "për shkak të ligjit", ç'ka del nga përmbajtja e akteve administrative që kanë dalë në këtë rast prej Komisionit të Ristrukturimit, si "Njoftimi për kryerjen e bisedimeve", që i përket akti me nr. 151 prot., datë 02.02.2015, si dhe procesverbali me nr. 191, datë 04.02.2015.

Konstatohet se është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe ajo financiare, me aktin administrativ nr. 36, datë 18.05.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre administrative për disa nëpunës të Këshillit të Qarkut, për arsye të rristrukturimit të administratës."

10. ***** , është nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, i emëruar në Këshillin e Qarkut Korçë, në pozicionin "Specialist", në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, nëpërmjet procedurave të konkurimit dhe konfirmuar si nëpunës civil në këtë pozicion me Urdhërin nr. 28, datë 06.08.2004.

Konstatohet se, me Urdhërin nr. 74, datë 01.02.2007, të titullarit të institucionit, ky punonjës është emëruar në pozicionin e punës "Inspektor", në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës.

Nëpërmjet aktit administrativ nr. 27, datë 12.05.2014, është deklaruar statusi i punësimit, si nëpunës civil në pozicionin e punës "Inspektor", në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës.

Nga verifikimi i materialeve të administruara në dosjen e personelit, rezulton se me Urdhërin nr.11, datë 10.02.2015, të titullarit të institucionit, ky punonjës është pezulluar nga shërbimi civil me motivacionin, "për shkak të ligjit", ç'ka del nga përmbajtja e akteve administrative që kanë dalë në këtë rast prej Komisionit të Ristrukturimit, si "Njoftimi për kryerjen e bisedimeve", që i përket akti me nr. 149 prot., datë 02.02.2015, si dhe procesverbali me nr. 197, datë 04.02.2015.

Konstatohet se është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe ajo financiare, me aktin administrativ nr. 36, datë 18.05.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre administrative për disa nëpunës të Këshillit të Qarkut, për arsye të rristrukturimit të administratës."

11. ***** , është emëruar në pozicionin e punës "Specialist", në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, sipas procedurave të konkurimit dhe është konfirmuar në këtë pozicion si nëpunës civil, me Urdhërin nr. 28, datë 06.08.2004, të titullarit të institucionit.

Më pas, konstatohet se kanë dalë disa akte emërimi që e kanë transferuar këtë punonjës në pozicione të ndryshme, pjesë e shërbimit civil dhe konkretisht, me Urdhërin nr. 77, datë 01.02.2007, të titullarit të institucionit, është emëruar në pozicionin e punës "Inspektor", në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës; me Urdhërin nr. 110 dt. 11.06.2007, është emëruar "Specialist", në Seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës dhe me Urdhërin nr. 113 dt. 02.07.2007, është emëruar në pozicionin e punës "Inspektor", në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës.

Nëpërmjet aktit administrativ nr. 26, datë 12.05.2014, këtij punonjësi i është deklaruar statusi i punësimit në kategorinë e nëpunësit civil, në pozicionin e punës "Inspektor", në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës.

Nga verifikimi i materialeve të administruara në dosjen e personelit, rezulton se me Urdhërin nr.10, datë 10.02.2015, të titullarit të institucionit, ky punonjës është pezulluar nga shërbimi civil me motivacionin, "për shkak të ligjit", ç'ka del nga përmbajtja e akteve administrative që kanë dalë në këtë rast prej Komisionit të Ristrukturimit, si "Njoftimi për kryerjen e bisedimeve", që i përket akti me nr. 148 prot., datë 02.02.2015, si dhe procesverbali me nr. 193, datë 04.02.2015.

Konstatohet se është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe ajo financiare, me aktin administrativ nr. 36, datë 18.05.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre administrative për disa nëpunës të Këshillit të Qarkut, për arsye të ristrukturimit të administratës."

12. ***** është emëruar për herë të parë në Këshillin e Qarkut Korçë, me aktin administrativ nr. 15, datë 03.03.2008 , në pozicionin "Inspektor", në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës.

Më tej konstatohet se me urdhërin nr. 46, datë 18.06.2009, pas përfundimit të procedurave të konkurimit është emëruar në pozicionin "Inspektor", në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës ku edhe është konfirmuar si nëpunës civil me Urdhërin nr. 121, datë 31.12.2010.

Nëpërmjet aktit administrativ nr. 25, datë 12.05.2014, këtij punonjësi i është deklaruar statusi i punësimit në kategorinë e nëpunësit civil, në pozicionin e punës "Inspektor", në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës.

Nga verifikimi i materialeve të administruara në dosjen e personelit, rezulton se me Urdhërin nr.9, datë 10.02.2015, të titullarit të institucionit, ky punonjës është pezulluar nga shërbimi civil me motivacionin, "për shkak të ligjit", ç'ka del nga përmbajtja e akteve administrative që kanë dalë në këtë rast prej Komisionit të Ristrukturimit, si "Njoftimi për kryerjen e bisedimeve", që i përket akti me nr. 147 prot., datë 02.02.2015, si dhe procesverbali me nr. 196, datë 04.02.2015.

Konstatohet se është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe ajo financiare, me aktin administrativ nr. 36, datë 18.05.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut, "Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe atyre administrative për disa nëpunës të Këshillit të Qarkut, për arsye të ristrukturimit të administratës."

Konkluzion: Pasi analizoi të gjitha kategoritë e punonjësve, për të cilët janë përdorur procedura të ndryshme të sistemimit të tyre pas procesit të ristrukturimit, Komisioneri, për të gjitha arsyet që u parashtruan në këtë kapitull, vlerëson se ndodhemi në kushtet e zbatimit të gabuar të ligjit nga ana e institucionit në një rast ristrukturimi dhe për këtë arsye, njësi përgjegjëse duhet të marrë masat për të rregulluar situatën, duke ndjekur radhën e veprimeve të rekomanduara për secilin rast të trajtuar më vete.

II. Disiplina në shërbimin civil (Masat disiplinore)

Instituti i disiplinës në shërbimin civil rregullohet në mënyrë të hollësishme në Kreun X "Disiplina në shërbimin civil" dhe përfshin nenet 57 deri 61 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Në këtë kapitull përcaktohen në mënyrë specifike përgjegjësia për masat disiplinore; llojet e masave disiplinore; kompetenca dhe procedura për masat disiplinore; parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore dhe shuarja e masës disiplinore.

Në zbatim të këtyre dispozitave, ka dalë Vendimi nr. 115, datë 05.03.2014 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil" dhe Udhëzimi nr. 1, datë 02.04.2014 i Departamentit të Administratës Publike "Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore".

Udhëzimi i Departamentit të Administratës publike, edhe pse është detyruar vetëm për instiucionet e administratës shtetërore, duhet të mbahet në vëmendjen e gjithë institucioneve të tjera që janë pjesë e shërbimit civil, pasi në përmbajtjen e tij janë sqaruar të gjithë elementët materialë dhe proceduralë të shqyrtimit të shkeljeve disiplinore dhe njëkohësisht, siguron zbatimin e unifikuar të ligjit për nëpunësin civil, në rastin e një ecurie disiplinore.

Pas verifikimit të dokumentacionit që na është vënë në dispozicion në lidhje me praktikën e masave disiplinore që janë aplikuar në këtë institucion, konstatohet se në 4 raste ka filluar procedurë disiplinore për punonjës të shërbimit civil, të cilët kanë qënë punonjës efektiv në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", (i ndryshuar).

Më poshtë po e paraqesim të individualizuar procesin për çdo rast të konstatuar.

1. Punonjësja ***** , është emëruar në Këshillin e Qarkut Korçë me Urdhërin nr.18, datë 25.03.2003, nëpërmjet procedurës së konkurimit, në pozicionin "Jurist" në Drejtorinë Juridike, ku edhe është konfirmuar si nëpunëse civile.

Më tej, konstatohet se me Urdhërin nr.98, datë 04.05.2007, të titullarit të institucionit, kjo punonjëse është emëruar në pozicionin e punës "Drejtor në Drejtorinë Juridike dhe Personelit".

Nisur nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit, rezulton se me Urdhërin nr. 45, datë 30.06.2014, "Largim nga Shërbimi Civil", të titullarit të institucionit, kjo punonjëse ka ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe ato financiare me institucionin, duke mos u zbatuar asnjë nga procedurat e kërkuara në dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore të analizuara në pjesën hyrëse të këtij kapitulli.

Konstatohet se fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, e ka gjetur në pozicion pune që është pjesë e shërbimit civil, për një periudhë mbi 1 vit dhe për këtë arsye duhet të trajtohet si nëpunëse civile.

Në këtë rast, Komisioneri konstaton se ndodhemi në kushtet e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, në kuptim të neni 115 e vijim të Kodit të Procedurave Administrative, e për këtë arsye nga ana e institucionit duhet të revokohet akti i largimit nga shërbimi civil, Urdhëri nr.45,

datë 30.06.2014, i titullarit të institucionit, pasi ky akt ka dalë në kundërshtim me procedurat ligjore, që duhen respektuar gjatë një procedimi disiplinor, duke i mohuar në këtë mënyrë, të drejtën punonjësit për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur në këtë rast.

Gjatë inspektimit u konstatua se ky rast është ende në proces gjyqësor, i cili është filluar nga kjo nëpunëse, në Gjykatën Administrative dhe ende nuk është zgjidhur në mënyrë përfundimtare nga gjykata.

2. Punonjësja ***** , ka filluar marrëdhëniet e punës me institucionin e Këshillit të Qarkut Korçë, me Urdhërin nr. 91, datë 12.11.2009, të titullarit të institucionit, në pozicionin "Specialist", në Drejtorinë e Projekteve Komunitare, duke mos respektuar procedurat e konkurimit.

Konstatohet se është larguar nga shërbimi civil me Urdhërin nr. 88, datë 30.12.2014 "Largim nga Shërbimi i Civil", për shkelje shumë të rënda.

Nisur nga momenti i fillimit të marrëdhënies së punës në këtë institucion (data 12.11.2009), kjo nëpunëse i plotëson kushtet për t'u deklaruar si nëpunëse civile, pasi ka qenë e punësuar në këtë institucion më shumë se një vit, më parë se të fillonin efektet juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Në këto rrethana, është verifikuar procedura e dhënies së masës disiplinore dhe rezultoi se, me Urdhërin nr. 84, dt. 16.12.2014 "Për ngritjen e Komisionit Disiplinor", është ngritur Komisioni i Disiplinës, në përmbushje të kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 59 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", si dhe të Vendimit nr. 115 dt. 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil", me përbërje të rregullt.

Eprori direkt, me shkresën nr. 1819, dt. 17.12.2014 "Kërkesë për fillimin e ecurisë disiplinore", ka njoftuar punonjësën e proceduar për shkakun e nisjes së kësaj ecurie disiplinore. Më tej, me shkresën nr.1821, dt. 17.12.2014 "Njoftim për mbledhje", është njoftuar punonjësja ndaj të cilës ka filluar ecuria disiplinore për datën e zhvillimit të takimit, (dt. 22.12.2014), akte që u verifikuan nga grupi i inspektimit, duke përfshirë edhe procesverbalin e mbledhjes, i mbajtur nga Komisioni Disiplinor, deklaratat e anëtarëve të komisionit, që konfirmojnë se nuk kanë konflikt interesi. Gjithashtu, procedura materializohet edhe në dy seancat dëgjimore dhe procesverbalet përkatëse, të nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Disiplinës dhe avokati që përfaqësonte punonjësën në këtë proces.

Në përfundim të procedurës, konstatohet se, me vendimin nr. 8, datë 26.12.2014, Komisioni i Disiplinës ka vendosur, marrjen e masës disiplinore "Largim nga shërbimi civil".

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se nga pikpamja procedurale, rezulton të jenë respektuar kërkesat e ligjit dhe të akteve nënligjore që sigurojnë një proces të rregullt të hetimit administrativ dhe ushtrimin e të drejtës së nëpunësit civil t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur gjatë një procedimi disiplinor.

Gjatë inspektimit u konstatua se ky rast është ende në proces gjyqësor, i cili është filluar nga kjo nëpunëse, në Gjykatën Administrative dhe ende nuk është zgjidhur në mënyrë përfundimtare nga gjykata.

3. Punonjësi ***** , është emëruar në Këshillin e Qarkut Korçë, me Urdhërin nr. 3 datë 31.01.2011 të titullarit të institucionit, në pozicionin "Drejtor në Drejtorinë e Investim Shërbimeve" dhe nuk u konstatua asnjë dokumentacion që të provojë se janë realizuar procedurat e konkurimit në këtë rast.

Nga verifikimi rezultoi se me aktin administrativ nr. 19, datë 12.05.2014, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, në kategorine e nëpunësit civil.

Konstatohet se ky punonjës është larguar nga shërbimi civil me Vendimin nr. 1, datë 05.09.2014, të Komisionit të Disiplinës "Largim nga Shërbimi i Civil", për shkelje shumë të rënda të disiplinës.

Në këto rrethana, është verifikuar procedura e dhënies së masës disiplinore dhe rezultoi se, me Urdhërin nr. 10, dt. 31.07.2014 "Për ngritjen e Komisionit Disiplinor", është ngritur Komisioni i Disiplinës, në përmbushje të kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 59 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", si dhe të Vendimit nr. 115 dt. 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil", me përbërje të rregullt.

Eprori direkt, me shkresën nr. 965, dt. 31.07.2014 "Kërkesë për fillimin e ecurisë disiplinore", ka njoftuar punonjësin e proceduar për shkakun e nisjes së kësaj ecurie disiplinore.

Më tej, me shkresën nr. 969, dt. 31.07.2014 "Njoftim për mbledhje", është njoftuar punonjësi ndaj të cilit ka filluar ecuria disiplinore për datën e zhvillimit të takimit, (dt. 22.12.2014), akte që u verifikuan nga grupi i inspektimit, duke përfshirë edhe procesverbalin e mbledhjes, i mbajtur nga Komisioni Disiplinor, deklaratat e anëtarëve të komisionit, që konfirmojnë se nuk kane konflikt interesi.

Gjithashtu, procedura materializohet edhe në seancat dëgjimore dhe procesverbalet përkatëse, të nënshkruar nga anëtarët e Komisionit të Disiplinës.

Në përfundim të procedurës, konstatohet se, me Vendimin nr. 1, datë 05.09.2014, Komisioni i Disiplinës ka vendosur, marrjen e masës disiplinore "Largim nga shërbimi civil".

Në këto rrethana , nga pikpamja procedurale, Komisioneri vlerëson se janë respektuar kërkesat e ligjit dhe të akteve nënligjore që sigurojnë një proces të rregullt të hetimit administrativ dhe ushtrimin e të drejtës së nëpunësit civil për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur gjatë një procedimi disiplinor.

Gjatë inspektimit u konstatua se ky rast është ende në proces gjyqësor, i cili është filluar nga ky nëpunës, në Gjykatën Administrative dhe ende nuk është zgjidhur në mënyrë përfundimtare nga gjykata.

4. Punonjësi ***** , është emëruar në Këshillin e Qarkut Korçë, me Urdhërin nr. 3, datë 31.01.2011, të titullarit të institucionit, si “Kryeinspektor” i Inspektoriatit të Ndërtimit.

Gjatë verifikimit nuk janë konstatuar procedura konkurimi, pasi ky pozicion pune, nuk rregullohej sipas ligjit nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil”, (tashmë i shfuqizuar), sepse në ligjin specifik për urbanistikën, parashikohej se statusin e nëpunësit civil, e gëzonin vetëm punonjësit e Inspektoratit Kombëtar të Urbanistikës dhe për këtë arsye, marrëdhënia e punës ka vazhduar e pa ndërprerë, por e rregulluar sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Pas fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, si pasojë e zgjerimit të fushës së shërbimit civil, duhet të përfshihen në skemën e shërbimit civil edhe pozicionet e punës që bëjnë pjesë në strukturën e Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik të Këshillit të Qarkut.

Kjo për faktin se në nenin 2 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është parashikuar në mënyrë të shprehur se, fusha e veprimit të ligjit, shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore.

Në këto rrethana, duke patur parasysh faktin se këto pozicione përfshihen në kategorinë e funksioneve që ushtrojnë autoritet publik në një njësi të qeverisjes vendore, që është Këshilli i Qarkut, Korçë, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kjo strukturë duhet të përfshihet në shërbimin civil dhe për pasojë, marrëdhëniet e punës duhet të rregullohen sipas ligjit për nëpunësin civil.

Nisur nga momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës me institucionin, që përkon me datën 31.01.2011, rezulton se fillimi e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur këtë punonjës në një pozicion pune, pjesë e shërbimit civil, për një periudhë më shumë se një vit. Për këtë arsye, ai duhet të trajtohet si nëpunës civil, duke i deklaruar statusin e punësimit, në kategorinë e nëpunësit civil, nga ana e njësisë përgjegjëse.

Ndërkohë, konstatohet se ky punonjës është larguar nga shërbimi civil për shkelje shumë të rënda, me Urdhërin nr. 53, datë 06.10.2014, të titullarit të institucionit, duke mos respektuar kërkesat e ligjit për të zhvilluar një procedurë të rregullt ligjore, që do të siguronte një proces të rregullt të hetimit administrativ dhe ushtrimin e të drejtës së nëpunësit civil për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur gjatë një procedimi disiplinor.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se ndodhemi në kushtet e pavlefshmërisë absolute të aktit, në kuptim të neni 115 e vijim të Kodit të Procedurave Administrative, e për këtë arsye nga ana e institucionit duhet të revokohet akti i largimit nga shërbimi civil, Urdhëri nr. 53, datë 06.10.2014, i titullarit të institucionit, pasi ky akt ka dalë në kundërshtim me procedurat ligjore që duhen respektuar gjatë një procedimi disiplinor, duke i mohuar në këtë mënyrë të drejtën punonjësit për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur në këtë rast.

IV. Procedura dhe formati i përshkrimit të punës

Sipas Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, përshkrimi i punës është një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm,

detyrave kryesore dhe përgjegjësi kryesore të një pozicionit respektiv të punës, që është pjesë e shërbimit civil.

Përshkrimi i punës shërben për të njohur nëpunësin civil me punën që duhet të kryejë; për vlerësimin dhe klasifikimin e pozicionit të punës; vlerësimin e rezultateve në punë dhe përcaktimin e kërkesave të veçanta për çdo pozicion pune në shërbimin civil.

Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ka sjellë edhe nevojën për hartimin e përshkrimeve të punës në përputhje me nënin 19 të këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, për të gjitha pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil, në institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të ligjit.

Nisur nga verifikimi i kryer në subjektin e inspektuar, rezulton se në këtë institucion nuk janë hartuar përshkrimet e punës sipas kërkesave të ligjit.

Organizimi dhe ndarja e detyrave dhe e punës në shërbimin civil për këtë institucion, bëhet nëpërmjet "Rregullores së Brendshme të institucionit", miratuar me vendim të Këshillit të Qarkut nr. 13, dt. 18.07.2012, "Rregullorja e Brendshme e Këshillit të Qarkut Korçë", ku janë të përcaktuara me hollësi, në zbatim të ligjit organik dhe të ligjeve të tjera që ndërthuren në veprimtarinë e këtij institucioni, përgjegjësitë dhe detyrat kryesore që duhet të përmbushë secili pozicion pune, sipas strukturës dhe organikës së institucionit, ndër të cilat edhe pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil.

Në këto kushte, nisur nga rëndësia e madhe që ka hartimi i formularit të përshkrimit të punës sipas përcaktimeve ligjore dhe të akteve nënligjore që rregullojnë në mënyrë specifike procedurën që kërkohet të zbatohet në këtë rast, Komisioneri rekomandon njësinë përgjegjëse që në vazhdim t'a konsiderojë si detyrë me prioritet të lartë, në mënyrë që përshkrimet e punës të përgatiten dhe t'i paraprijnë procesit të ristrukturimit dhe më tej procesit të konkurimeve që do të zhvillohen në të ardhmen.

Ky proces vlerësohet me shumë rëndësi, për faktin se të gjithë elementët e përshkrimit të punës që trajtohen me hollësi në udhëzimet e përmendura më sipër, ndikojnë në mënyrë direkte në **a)** organizimin e veprimtarisë institucionale në funksion të arritjes së misionit, **b)** në përcaktimin e edukimit arsimor që duhet të ketë nëpunësi, **c)** në momente ristrukturimi, **d)** për të kontrolluar aktivitetin e nëpunësit, **e)** për vlerësimin e tij në fund të vitit kalendarik, si një detyrim ligjor, e në aspekte të tjera gjatë administrimit të shërbimit civil.

V. Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civil

Ligji nr.153/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, (Kreu XI, neni 62), përcakton detyrimin e institucioneve për të vlerësuar punën e çdo punonjësi që kryen funksione në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Vlerësimi i performancës ka pasoja të rëndësishme për një nëpunës civil në disa drejtime, ndër të cilat, konfirmimi i tij gjatë periudhës së provës, ndërprerja e marrëdhënies së punës pas dy vlerësimeve të njëpasnjëshme negative, ka rol vendimtar në sistemin e karrierës, pasi favorizon

lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë, si dhe luan një rol të rëndësishëm për risistemimin e nëpunësit në një rast ristrukturimi.

Nisur nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen personale të nëpunësve civilë të institucionit, konstatohen vlerësime pune që i përkasin periudhës para vitit 2014, të kryera në zbatim të ligjit të mëparshëm, që rregullonte marrëdhëniet në fushën e shërbimit civil, (ligji nr.8549 "Statusi i nëpunësit civil", tashmë i shfuqizuar), pra para fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri.

Vlerësimi i rezultateve në punë është procesi i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si edhe i aftësive ose dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave, që realizohet çdo 6 muaj (pika 1, neni 62).

Përveç vlerësimit, sipas paragrafit të mësipërm, nëpunësit vlerësohen periodikisht, sipas përcaktimeve me Vendimin nr. 109, datë 26.2.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë", të Këshillit të Ministrave, edhe për përfitim dhe përditësimin e njohurive shtesë të nevojshme për realizimin e funksioneve të tyre, në përputhje me kategorinë/grupin e administrimit të përgjithshëm/posaçëm ku bëjnë pjesë.

Në çdo rast, procesi i vlerësimit të kryer sipas kësaj pike, duhet të garantojë anonimatën e nëpunësit civil të vlerësuar.

Nëpunësi mund të vlerësohet në një nga këto nivele: a) "shumë mirë"; b) "mirë"; c) "kënaqshëm"; ç) "jokënaqshëm".

Sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë: a) është procesi vjetor i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuar në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive apo dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave; b) shërben për të marrë vendime objektive në lidhje me periudhën e provës, ngritjen në detyrë, lirin nga shërbimi civil, përparimin në hapat e pagës, si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Vlerësimi i rezultateve në punë është një proces që përsëritet çdo vit. Viti i vlerësimit është i njëjtë me vitin kalendarik.

Në rastin e vlerësimit të rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës, viti i vlerësimit llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil.

Sa më sipër, ç'ka pasqyrojnë rregullime të posaçme të parashikuara shprehimisht në ligjin dhe aktet nënligjore që disiplinojnë fushën e shërbimit civil në lidhje me këtë institut të rëndësishëm, Komisioneri **rekomandon** njësinë përgjegjëse, që t'i vlerësojë drejt dhe t'i mbajë parasysh gjatë drejtimit të këtij procesi, të cilin e ka si detyrim ligjor, si dhe gjatë koordinimit të punëve me të gjithë pjesëmarrësit në këtë proces.

Komisioneri vlerëson se procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i vështirë që kërkon punë të vijueshme dhe të materializuar në shënime periodike dhe sistematike, nominale nga ana e punonjësve të ngarkuar me implementimin e tij, të cilët paraqiten në rolin e Zyrtarit Autorizues dhe Kundërfirmues, për nëpunësit civil në pozicione që i përkasin shërbimit civil.

Shënimet periodike të eprorit të drejtpërdrejtë për ecurinë e nëpunësit gjatë vitit të vlerësimit, duhet të shoqërojnë formularin e vlerësimit, si dhe duhet të ruhen në dosjen e personelit. Ky është një detyrim ligjor i eprorit të nëpunësit që do të vlerësohet dhe që në fakt duhet të mbahet parasysh gjatë procesit të vlerësimit të punës, për të siguruar vërtetësinë dhe objektivitetin e procesit në tërësi.

Në këto kushte, Komisioneri çmon se njësia e burimeve njerëzore, duhet të fillojë menjëherë punën për të krijuar kushtet që procesi i vlerësimit të punës të fillojë dhe të zhvillohet në të gjitha fazat e tij, deri në finalizimin me një vlerësim përfundimtar të argumentuar.

Më tej, në drejtim të përsosjes së procesit dhe të eliminimit të vlerësimeve subjektive, duhet të punohet nga njësia e personelit për të arritur disiplinimin e eprorëve për të mbajtur shënime për arritjet e nëpunësve civilë gjatë vitit të vlerësimit, duke planifikuar trajnime në këtë fushë për nëpunësit e ngarkuar me vlerësimet, si dhe nëpërmjet kontrollit të eprorëve, për të mbikëqyrur procesin e vlerësimit, të shtrirë gjatë gjithë vitit kalendarik.

VI. Përmbajtja dhe administrimi i dosjeve të personelit dhe Rregjistri i Personelit

a. Dosja e Personelit

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës verifikoi dosjet e personelit për të parë nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se janë të përfshira dokumenta me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit të Ministrave, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, rezultoi se në çdo dosje janë të administruara dokumenti i identifikimit (*fotokopje e letërnjoftimit*); dokumenti mbi gjendjen civile (*çertifikata e gjendjes familjare*); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor dhe fushën e studimeve (*fotokopje e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave*); dokumentet që vërtetojnë datën e fillimit të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*); etj.

Plotësimi i këtyre kërkesave është pasqyruar për secilin nëpunës në Aneksin nr. 1 dhe aneksin nr. 2, që i bashkëlidhen raportit, si pjesë e tij.

Në përfundim të verifikimeve të kryera në institucionin e mbikëqyrur konstatohet se, në dosje mungojnë përshkrimet e punës dhe vlerësimet e punës, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Në këtë rast, pasi të përfundojë procesi i hartimit të përshkrimit të punës dhe vlerësimit të punës, një kopje e këtyre akteve duhet të administrohet në dosjen e personelit.

Kjo për faktin se, përshkrimi i punës, në pjesë të veçanta të tij, trajton aspekte të ndryshme që kanë lidhje me gjithë dinamikën e karrierës së nëpunësit civil, ndër të cilat, kërkesat e posaçme të vendit të punës, nivelin e edukimit arsimor, fushën kryesore të studimeve, përvojën në punë, njohuritë dhe aftësitë e përgjithshme dhe specifike që nevojiten për pozicionin e punës.

Në një rast ristrukturimi, lëvizje paralele, ngritje në detyrë, apo nëse nëpunësi kërkon të njihet me dosjen e tij, nevoja për të dhënat individuale të nëpunësit është evidente, e për këtë arsye, të gjitha dokumentat, përfshirë edhe përshkrimin e punës, duhet të administrohen në dosjen personale të çdo punonjësi.

Ndërkohë, është konstatuar se mungojnë edhe për pasojë duhet të plotësohet dosja me dokumentin që vërteton kushtet shëndetësore dhe gjendjen gjyqësore, për të gjithë punonjësit pjesë e shërbimit civil, me qëllim që të mundësohet verifikimi i plotësimin të kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, të përcaktuara në nenin 21, pikat "ç" dhe "d", të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil".

Konkluzion: Konstatohet se, dosjet e personelit janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, ndërkohë që duhet të vijojë puna për të plotësuar dosjen e personelit me aktet që janë evidentuar si mangësi në këtë pjesë të materialit, si dhe me dokumentacionin që materializon procedurën e konkurimit nëpërmjet ligjit nr. 8549/1999 "Statusi i nëpunësit civil" (tashmë i shfuqizuar).

b. Regjistri i personelit

Regjistri i personelit është një dokument i krijuar sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe vendimit nr. 117, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".

Në kushtet kur, ende nuk është bërë funksional Regjistri Qendror i Personelit, që administrohet nga Departamenti i Administratës Publike, në një mënyrë specifike sipas përcaktimeve të bëra në një akt nënligjor të veçantë, rezulton se të dhënat që përmban regjistri i institucionit, pasqyrojnë gjendjen reale të burimeve njerëzore në këtë subjekt.

VII. Planifikimi i pranimit në shërbimin civil.

Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe të Vendimit nr. 108, 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", çdo institucion i administratës shtetërore përgatit planin e nevojave të tij për rekrutim në shërbimin civil për vitin e ardhshëm.

Konstatohet se nga ana e Këshillit të Qarkut Korçë, ky proces nuk është realizuar dhe për këtë arsye, Komisioneri **rekomandon** që njësia përgjegjëse të hartojë planin e pranimeve në shërbimin civil, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë institut të ligjit.

* * *

Ndërkohë, në lidhje me disa institute të ligjit, të cilat janë pjesë e programit të punës, si rekrutimi, pezullimi, lëvizje paralele, ngritje në detyrë, Komisioneri ka konstatuar se në këtë institucion nuk janë aplikuar procedura që të materializojnë këto institute dhe për këtë arsye këto procese nuk gjenden të materializuara në raportin përfundimtar të inspektimit.

* * *

Këto ishin rrethanat e konstatuara gjatë inspektimit të përgjithshëm të kryer në Këshillin e Qarkut Korçë, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", (i ndryshuar), gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA